



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e parë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 28.1.2016 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1. Plani operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

2.2. Miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunitat fqinje në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2.3. Propozim Vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndërkomunal me Komunitat fqinje në sferën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

2.4. Propozim vendimi për formimin e Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të integritetit

2.5. Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjatë (99 vite) për ndërtimin dhe vendosjen e Trafostacioneve 10(20) KW

2.6. Raporti i suksesit të nxënësve në fund të gjysmë vjetorit të parë 2015/16

2.7. Raportet e punës së Komiteteve të KK-Gjilan për vitin 2015

2.8. Raporti vjetor i Departamentit të Prokurimit për Kontratat e nënshkruara Publike

3. Të ndryshme.

Seanca i filloi punimet në ora 10.20 min

Në punimet e seancës së parë të vitit 2016 morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Përfaqësuesja e OSB-së, znj. Sadete Ternava

Përfaqësuesi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i OJQ “Lansdowne” Shaban Terziu

Mediet

Seancën e parë të vitit 2016 e hapi dhe e udhëhoqi kryesueseje Kuvendit zonja Valentinë Bunjaku-Rexhepi e cila i përshëndeti të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë të cilët i monitorojnë punimet e kësaj seance.

Në fillim të punimeve, kryesuesja kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit dhe të miratohet procesverbali.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar.

Në punimet e seancës së parë ishin të pranishëm 34 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi një – Sergjan Mitroviç

Procesverbali i seancës së kaluar nuk pati vërejte dhe u aprovua pa vërejtje, me 34 vota .

Në vijim të punimeve, kryesuesja e hapi debatin për rendin e punës.

Sahit Abazi- përveç rendit të punës, në emër të grupit të PDK-së kërkoj që t’i kemi edhe dy sqarime të tjera ; e para ka të bëjë me një konkurs në Shëndetësi dhe e dyta ka të bëjë me një veprim për të cilin kemi kërkuar disa herë që Komuna të jetë syhapur, sepse mund të ndodhin edhe raste me pasoja fatale dhe në këtë rast është fjala për qentë endacak.

Ne e kemi një rast të konfirmuar se një fëmijë është i sulmuar nga qentë, një rast është në Livoç të Ulët dhe në një tjetër rast tjetër janë të sulmuar mësimdhënësit e Shkollës “Abaz Ajeti”. Unë e kuptoj Drejtorinë e Bujqësisë se mund të ketë pengesa ligjore për t’i eliminuar këta qen, por nuk e kuptoj se nëse ndodh ndonjë rast me pasoja fatale, nuk e kam të qartë se cili legjislacion na e mbulon këtë turp? Ky nuk është vetëm reagimi i ynë, por është edhe i qytetarëve, kurse në anën tjetër shohim numër gjithnjë e më shumë të qenve endacak.

Kërkoj nga drejtori që të na e caktojë një afat se deri kur nuk do të ketë qen endacak nëpër rrugë dhe rrugica, por edhe në hapësira të shkollave dhe institucioneve të tjera?

Në anën tjetër sa i përket konkursit në Shëndetësi si rast i parë ka ndodhur një shëmti me rastin e nënshkrimit të kontratave të atyre që janë përfitues. Sipas rregullave nëse bëhet intervista, shpallet konkursi, maksimumi është tri ditë tri ditë për ata që kanë përfituar t’i nënshkruajnë kontratat. Mirëpo përpilimi i listave të atyre që kanë përfituar ka ndodhur me disa javë ose muaj vonesë janë nënshkruar kontratat.

Me këtë rast është bërë një pranim militantesk të aktivistëve të LDK-së në këtë konkurs.

Gjithashtu është edhe një shkelje tjetër, sepse në konkurs parashihet për t’i pranuar 18 motra, kurse pranohen 35. Listë tjetër e rekomandon komisioni i konkurseve, kurse në një listë tjetër pranohen dhe publikohet. Ne kërkojmë që të anulohet ky konkurs për shkak të shkeljeve dhe të rishpallet konkursi, sepse shëndetësia nuk mund të shndërrohet në institucion militantesk, sepse aty duhet të shkojnë më të mirët dhe nuk guxojmë ta shikojmë anën partiake. Ne kërkojmë që ky konkurs të anulohet dhe të shpallet përsëri për shkak të shkeljeve të rënda që janë bërë.

Nevzad Isufi- pasi që është seanca e parë e këtij viti i uroj sukses të gjithëve në seancat e këtij vitit që do t’i kemi. Mirëpo menjëherë jam i obliguar të jap vërejte dhe në radhët të parë për shkak të materialit të seancës i cili kësaj radhe nuk ka ardhur si material fizik për disa pika. Nuk ka material voluminoz me përjashtim të pikës për siguri e cila pikë e rendit të punës i ka mbi 330 faqe për të cilën pikë nuk do të

kërkoja material fizik, por janë disa pika të tjera për të cilat i tërë materiali nuk ka mbi 20 faqe dhe në këtë mënyrë kjo mangësi nuk duhet të na përsëritet herëve të tjera. Ne kur e kemi materialin përpara mund të diskutojmë dhe t' i qasemi temave më mirë, kurse në mënyrë elektronike është pamundur t' i analizojmë ashtu si duhet temave të cilat duhet debatuar.

Në anën tjetër po e përsëris se jemi në vitin e tretë qeverisë dhe ende nuk na janë siguruar e llap-topët e të cilët shumë herë janë premtuar.

Lidhur me pikën e rendit të punës : Planet e punës së komiteteve, nuk është si pikë e rendit të punës, prandaj shtrohet pyetje është ndonjë gabim teknik apo çka është në pyetje?

Gjithashtu edhe Plani i punës së Kuvendit i cili është aprovuar në seancën e kaluar ka nevojë që të përmirësohet në disa fusha dhe propozoj që si rend i punës të futet edhe plotësohet rendi i punës së paku në pikën të ndryshme. Janë disa fusha në të cilat nuk është asnjë aktivitet i paraparë në seancat vjetore e që si shembull i tillë është Administrata e Përgjithshme, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, Kultura, Rina dhe Sporti, Bujqësia dhe Pylltaria vetëm një çështje, Zhvillimi Ekonomik, Komunitetet dhe Urbanizmi asnjë, Inspeksioni asnjë, Integrimet Evropiane asnjë, Mbrojtja dhe Siguria dhe Barazia Gjinore asnjë, por edhe Liritë dhe Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut asnjë çështje. E radhës do të ishte që në radhë të parë të shqyrtohen planet e komiteteve, pastaj ato të plotësohen në planin e përgjithshëm të Kuvendit dhe jo kështu në mënyrë të mbrapshtë, njëherë Plani i Kuvendit, pastaj i komiteteve.

Sa i përket pyetjeve e kam një lidhur me KKSB-në se a është debatuar ky plan me qytetarë dhe nëse nuk është shqyrtuar përsëri kemi shkelje të procedurave.

Mandej ka anëtarë të komiteteve të cilët janë shërbyes civil dhe kjo duhet se është shkelje ligjore, prandaj mos të fillojmë menjëherë me këso shkelje ligjore, e sidomos nuk mund shërbyesi civil të jetë kryetar i komitetit. Të gjitha këto janë konflikt interesi dhe duhet përmirësuar.

Valnetinë Bunjaku –Rexhepi- që nga seanca e ardhshme asnjë material nuk do ta keni si kopje fizike, sepse procedura për llap-topët është duke u bërë dhe tash e tutje do ta keni materialin në adresë elektronike.

Nevzad Rushiti- unë po ndërlidhem me z. Isufi i cili e përmendi Planin e Kuvendit për vitin 2016 i cili është aprovuar në seancën e kaluar, prandaj nuk është mirë për ta marrë fjalën dhe për t' i kthyer prapa, sepse kjo është temë e cila është shqyrtuar. Unë mendoj se ai komision është i përbërë prej të gjitha strukturave që janë këtu brenda dhe kemi punuar për këtë plan, kurse raportet e drejtorëve epen në çdo gjashtë muaj dhe në fund të vitit.

Nevzad Isufi- më duket se me kolegun ose nuk jemi kuptuar mirë ose është një keqkuptim, sepse asnjëherë nuk është gabim nëse tentojmë për ta përmirësuar ndonjë gabim ose aty ku është bërë ndonjë gabim. Mandej unë nuk fola për raportet e drejtorëve, por fola për planet e komiteteve e që ka qenë dashtë të jenë para planit të Kuvendit. Nuk e di se çka ka të keqe nëse diku bëjmë përmirësime?

Fehmi Sylejmnai- ne sot e kemi seancën e parë të këtij viti dhe ju e dini se për herë të parë e kam ngrit çështjen e një pike ashtu siç bëhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës- deklarimi jashtë rendit të ditës, por për këtë ka pas premtuar edhe kryetari ta modifikojmë dhe ta propozojmë me një emër tjetër. Pasi që jemi në fillim të vitit është mirë kjo pikë të radhitet në rend të punës e shkruar në letër dhe jo në këtë formë si po bëhet. Ko është e mirë në

radhë të parë për drejtorët, sepse nuk kanë nevojë kaq gjatë të qëndrojnë në sallë kur kanë obligime të tjera. Nganjëherë kur po kemi pyetje shpesh, ndoshta drejtorët e dalin nga salla, sepse me siguri janë të ngarkuar edhe me punë të tjera.

Unë kam pyetje për kryetarin, por kryetari nuk është këtu, por me siguri dikush mund të përgjigjet; ne e dimë se në Lagjen “Dardania” ka përfunduar Qendra Sportive Rekreative, por ende nuk është përfunduar.

Pse nuk ka ndodhur ende ky përrurim për shkak të sezonës së dimrit dhe si mendohet të punohet dhe organizohet ajo qendër sportive?

E dyta pse është bërë zvarritja e shpalljes së listës së mësimdhënësve që është bërë nga DKA dhe kush jep llogari, pse kjo listë nuk është publikuar në afat ligjor?

Gjithashtu i kemi edhe dy paralele që janë formuar në mjekësi dhe artet pamore e që janë jashtë formuar jashtëligjshëm dhe këtë e ka konfirmuar edhe drejtori se ai nuk e ka bërë, por e ka bërë kryetari dhe kjo nuk është në pajtim me ligjin, sepse konkursin për shtim të numrit të paraleleve, konkursin e shpallë Ministria e Arsimit dhe jo kryetari i Komunës.

Një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë, por edhe për kryetarin e këtij komiteti dr. Jashar Jashari : e para është një barnatore e cila punon vetëm një ndërrim në QKMF dhe atë deri në ora 14. A ka mundësi që kjo barnatore të punojë edhe pas dite deri në ora 20 aq sa punon edhe QKMF-ja? Këto po e kërkoj, sepse ka pacient shumë dhe ata pas orës 14 janë të obliguar që barnat t' i marrin në barnatore private.

E dyta pyetje ka të bëjë m fshatin Zhegër e cila është një qendër shumë e madhe, por edhe në këtë fshat punon QMF, por punon vetëm me një ndërrim. Ne kërkojmë që në këtë QMF të punojë ekipi mjekësor edhe pasdite, sepse ka nevojë ajo anë që ta ketë mjekun deri në ora 20. Në fund kërkoj që ta kemi një mbledhje të veçantë për papunësinë në përgjithësi në Komunën e Gjilanit.

Valnetinë Bunjaku –Rexhepi- sa i përket Planit të Kuvendit po përgjigjem unë, sepse kërkesën që e kemi bërë publike ka qenë deshtë me shkrim është deshtë të bëhet dhe ne pastaj kemi qenë të obliguar ta fusim në plan të Kuvendit, kurse e dyta ju anëtarin e juaj nuk e keni dërguar në Komision për të dhëni propozime dhe sugjerime.

Isa Agushi- unë pajtohem me z. Isufi i cili thotë se duhet të kemi kopje fizike këtu, por nëse ju nuk mundeni ose nuk dëshironi për të na dërguar kopje fizike, atëherë krijoni kushtet t' i kemi llap-topët dhe të kemi internet në këtë sallë. Ne duhet atë material ta lexojmë këtu, por kushtet aktualisht nuk ekzistojnë. Unë kërkoj që për çdo pikë të rendit të punës të na sillni materialin për ta ditur se çka të diskutoj dhe çka të kërkoj.

Riad Rashiti- në pika të shkurtra do ta paraqes një shqetësim timin e për të cilin shqetësim po e ngris në çdo seancë dhe është fjala për mos përgjigje në pyetjet tona e të cilat nuk i bëjnë asnjë zyrtar me përjashtim të ndonjërit. Është e pakuptimtë dhe papërgjegjësi që nga muaji i pestë deri në janar të këtij viti unë nuk kam marrë përgjigje të cilat i kam bërë me shkrim, kurse përgjigjet mungojnë përherë.

Është shqetësuese dhe për të dyshuar se cila është arsyeja e mos përgjigjes e sidomos të atyre kërkesave që kanë të bëjnë me rendin e punës të kësaj seance. Ne sot kot e pyesim drejtorin e Prokurimit në këtë seancë kur të vijë radha, sepse ai nuk na kthen përgjigje.

Nuk ka mund të kthejë përgjigje prej datës 5 janar e të cilit ia kam drejtuar disa kërkesa. Nuk është përgjigj në kërkesa të tjera për ta plotësuar raportin të cilin e ka sjell sot në Kuvend dhe kjo është papërgjegjësi dhe është për të dyshuar se cila është arsyeja që ky drejtor i fsheh milionë € dhe është fjala për grandet e Qeverisë së Kosovës e të cilat kanë qenë të ndara për vitin 2015, për asfaltim të rrugëve në qytetin e Gjilanit 646 mijë €, ndërtimi i rrugëve në fshatrat e Gjilanit 1 milion e 170 mijë € dhe për këtë buxhet që është diku 2.5 milion € nuk ka qenë në gjendje të na e sjell një përgjigje shumë të shkurtër dhe të thjeshtë sa për ta ditur se a është shfrytëzuar granti i Qeverisë së Republikës së Kosovës i cili ka qenë i planifikuar për Komunën e Gjilanit? Ky drejtor i fsheh gjërat elementare ligjore dhe ne jemi në terr informativë si asamblistë dhe nuk mund ta kryejmë detyrën tonë ashtu siç duhet. E kemi kërkuar përbërjen e komisioneve për vlerësimin e ofertave dhe atij për mbikëqyrje që kanë ndodhur në tenderët për investime kapitale, por nuk ka ndodhur as kjo dhe nuk kemi përgjigje. E kemi kërkuar listën e kontratave të realizuara e cila është sjell pjesërisht, por ashtu siç duhet, por kemi kërkuar qasje zyrtare edhe për disa tenderë, sepse ne dëshirojmë për ta ditur pse ka pasur rritje enorme të vlerave të tenderëve të krahasuara me vitin 2014. Kjo është fshehje dhe ikje e transparencës dhe për neve është shqetësuese, sepse ky drejtor duhet të na lejoj që të na i jep informacionet në bazë të ligjit.

Gjithashtu edhe kryetari i Komunës, vazhdon të jetë i mbyllur për neve, sepse gjatë vitit 2014 dhe 2015 asnjëherë asnjë kërkesë dhe asnjë përgjigje të vetme nuk e kemi marrë nga kryetari.

Valnetinë Bunjaku –Rexhepi- z. Rashiti gjatë fjalës së tij e përmendi edhe fondin humanitar se gjëja ne nuk po i bëjmë transparente këto mjete, por kjo është një krenari dhe mburrje dhe nuk mund të ketë dyshime edhe pse nuk e ke marrë përgjigjen. Kjo është krenari për këtë qeveri dhe nuk ka bazë për asnjë dyshim.

Riad Rashiti- unë nuk po dyshoj, por në kohën kur ju asnjëherë nuk ktheni përgjigje dhe nuk e di pse nuk po raportoni, sepse kjo është në dobi të juaj. Juve iu duhet shumë punë për të bërë sa ka bërë Qeverisja e PDK-së, sepse ka strehuar shumë më tepër familje me gjendje të rëndë sociale.

Shukrie Rapuca- e kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: “ Pse z. Drejtor në “Lagjen e Zabelit të Sahit Agës” edhe ato rrugë të pakta që janë të asfaltuara (2-3), mungon ndriçimi dhe është fjala për një rrugë mjaft të rëndësishme, sepse e lidh qendrën e qytetit me lagjen që nga Xhamia e Vogël deri te qendra e lagjes mungon ndriçimi. Ky rast është në vendin ku nuk ka as shtëpi afër dhe është në tërësi në terr.

Leonorë Bunjaku- kohëve të fundit në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës sonë kanë ndodhur shumë gjëra të këqija dhe janë të shqetësuar nxënësit, mësimmhënësit dhe prindërit. Shkollat tona pas vonesës së shpalljes së rezultateve të konkursit, kemi pasur rast kur për një vend pune janë zgjedhur dy mësimmhënës dhe për këtë arsyeje është shkaktuar konflikt dhe mosmarrëveshje në mes të mësimmhënësve.

Në shkollat fillore po ashtu ka pasur rast kur për pesë javë rresht nxënësit kanë qenë pa mësimmhënës.

Në kohë të fundit nxënësit protestojnë dhe kërkojnë mësuesen pasi është bërë rutinë në këtë qeverisje që të ndërrohen mësuesit sipas dëshirës së dikujt, sepse duhet rehatuar ndonjë militant të cilët me çdo kusht gjatë fushatës zgjedhore iu është premtuar ndonjë vend pune.

Unë do ta sqaroj një rast dhe do ta pyes drejtorin se zonja Bukurie Musliu sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit dhe sekretarit të përhershëm e ka fituar të drejtën për punë. Për këtë arsyeje unë kërkoj nga drejtori i Arsimit që të kërkojë falje publikisht, sepse është dëmtuar imazhi i kësaj zonje duke thënë se ajo nuk ka diplomë valide, kurse në anën tjetër me të njëjtat diploma janë pranuar mësimmhënës e të cilët edhe sot janë në marrëdhënie pune.

Në fund në emër të nxënësve dhe mësimmhënësve të Gjimnazit të Shkencave Natyrore dëshiroj për ta ditur se çka ka ndërmarrë drejtori diçka sa i përket sallës së edukatës fizike?

Në qeverisjen e kaluar është investuar mjaft në infrastrukturën shkollore dhe pse nuk po vazhdon kjo traditë.

A jeni në dijeni se salla e edukatës fizike është jofunksionale dhe në shumë vende rrjedh uji nga të reshurat atmosferike. Ju lus që të merrni masa urgjente për këtë sallë dhe ta bëni funksionale.

Arijetë Rexhepi- unë i kam disa shqetësime përkitazi me rrugët në qytet, sepse në rrugë të qytetit janë shlyer shiritat e bardhë të rrugëve e të cilët patjetër duhet të vendosen, sepse është tepër e nevojshme.

Shqetësimi tjetër është se Rruga e Prishtinës është shtruar me asfalt, kurse trotualet ende nuk janë rregulluar.

Gjithashtu te ish Kampi “Month” është bërë një depo mbeturinash, kurse nga Komuna ai vend është shpallur me interes të veçantë. Është në interes të qytetarëve që të eliminohen këto dukuri e të cilat janë mjaft shqetësuese.

Krenare Latifi- kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: në pjesën tabelare të vendimit për buxhetin e Komunës së Gjilanit për vitin 2016 për fushën e shërbimeve publike dhe për investimet

kapitale, është paraparë shuma prej 1 milion €, por nuk janë përcaktuar projektet të cilat do të realizohen në këtë vit?

Po ashtu edhe në Kuvend nuk është shqyrtuar dhe miratuar Plani i punës së Departamentit të vitit për vitin 2016. Pyetja e ime konkret është se cilat janë projektet e investimeve kapitale për vitin 2016 ?

Valnetinë Bunjaku –Rexhepi- nuk ka debatues të tjerë, kurse përgjigjet nga drejtorët i merrni nën të ndryshme, sepse Kuvendi njëherë në muaj mbahet. Ju lus kusht është për aprovim të këtij rendi të punës?

Aprovohet rendi i punës me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1. Plani operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Ensar Kadriu- për Planin operative emergjent sqarimet i dha drejtori i kësaj drejtorie, por të cilin Plan anëtarët e Kuvendit e kanë në detale në materialet e seancës.

Isa Agushi- ne e kemi shqyrtuar këtë Plan dhe në komitet ka kaluar, sepse është një Plan i detajuar shumë mirë, por po të veprohej edhe në praktikë ashtu si është në letër do të jetë edhe më mirë. Mirëpo kjo drejtori është shume e ndjeshme, sepse Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim merret me fatkeqësi natyrore për të cilat nuk do të kishim pas dëshirë që të ndodhin, por edhe nëse ndodhin, kjo drejtori e ka një obligim të veçantë për mbrojtje të qytetarëve. Kësaj drejtorie duhet urgjentisht t' i shtohet buxheti, sepse me këtë buxhet shumë të varfër kjo drejtori nuk mund t' i dal zot fatkeqësive natyrore eventuale që mund të ndodhin në Komunën e Gjilanit. Ne në Komunë nuk kemi strehimore për raste emergjente, nuk kemi as rezerva ushqimore dhe deri më tash nuk kemi ndërmarrë asgjë për përmirësim të infrastrukturës për këtë drejtori.

Unë vazhdimisht kam kërkuar që kësaj drejtorie t' i epet prioritet me buxhet shtesë, por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë, por kjo drejtori duhet të merret edhe me trajnime të ndryshme nëpër shkolla dhe me qytetarë.

Sepse ndoshta dikur do të bëhet shumë vonë. Në emër të grupit të LDK-së ne e përkrahim planin e kësaj drejtorie.

Riad Rashiti- ky plan është i mirë aq sa kemi pasur mundësi për ta analizuar ne, por unë e mbështesë mendimin e kolegut sa i përket buxhetit të kësaj drejtorie. Është e domosdoshme që të ketë një rritje të buxheti për vitet e tjera. Mirëpo pyetja është se janë të gatshme kompensimet përkitazi me dëmet që kanë qenë më 2014, nga vlerësimet të cilat kanë ndodhur e që janë dëmtuar shumë biznese dhe familje?

Nënkryetari i Komunës dhe ju zonja kryesuese keni premtuar se do të kompensohen qytetarët për pasojat e vërshimeve, prandaj a janë gati ato para nga Qeveria apo jo?

Nevzad Isufi- unë më parë e shtrova këtë pyetje për këtë Plan dhe kërkoja që ta di se ky Plan a ka kaluar nëpër debat me qytetarë dhe duke ditur se KKSB është kompetent për çështje të Sigurisë dhe e përfshin edhe çështjen e emergjencave, prandaj me sa e di unë ky Këshillë nuk e ka shqyrtuar këtë çështje. Nëse është kështu unë mendoj se këtu është një mangësi sa i përket procedurës së shqyrtimit të këtij plani. Sa i përket Planit është mjaft i gjerë dhe ndoshta ka qenë e nevojshme të reduktohet pak, sepse sa i përket volumit ndoshta do ta kishte marrë maksimumin e pikëve.

Valentina Bunjaku- Rexhepi – ky Plan ka kaluar në KKSB dhe kush ka qenë i interesuar ka mund të marrë pjesë dhe ka pasur mundësi të lexohet materiali për 30 e më tepër ditë.

Nevzad Isufi-a ka pasur debat me qytetarë?

Valentina Bunjaku- Rexhepi- duhet lexuar Rregulloren se a është e nevojshme të kalojë në KKSB!

Selami Xhemajli- unë në emër të grupit të anëtarëve të AAK-së e përkrahim këtë plan për emergjencë duke marrë parasysh se Komuna e Gjilanit ka përjetuar fatkeqësi natyrore në vitin 2004 dhe më 2007, unë them se ky është një plan mjaft voluminoz dhe mirë i punuar teknikisht dhe profesionalisht. Ka vend edhe për plotësime, sepse thuhet se edhe alarmet nuk janë funksionale, por me pak mjete ato mund të riparohen, por në përgjithësi në emër të grupit i jap mbështetje.

Avdyli Aliu- nëse dikush do të marrë përgjigje, kolegu thotë kështu: “Ky plan është në harmoni me kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet, aktet në fuqi. Po ashtu është plan i përpunuar në bashkëpunim me Administratën e Komunës së Gjilanit, MPB-së, Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe Shoqërisë Civile me institucione, organizata vullnetare dhe publikun e gjerë.” Me këtë duket se ka pasur mjaft faktor relevant e të cilët janë marrë me këtë plan shumë të rëndësishëm.

Arben Maliqi- e përshëndes edhe unë drejtorin për këtë plan operative të cilin drejtori në mënyrë të përpiktë e paraqiti, por unë po e jap edhe një këshillë që në bashkëpunim me drejtorin e Arsimit të aplikojnë një lloj simulimi nëpër shkollat fillore pasi që dihet se Gjilani është vend seizmik dhe kemi problem me dridhje të tokës. Është mirë që ne ta aplikojmë një mënyrë të tillë simuluese në mënyrë që nxënësit në raste emergjente t’i përdorin edhe shkallët e të cilat janë nëpër shkolla. Këtë sugjerim duhet ta keni parasysh me drejtorin e Arsimit.

Riad Rashiti- unë nuk mora përgjigje dhe mos u trembuni, sepse sa herë po kërkojmë llogari për buxhet, ju po iu shmangeni pyetjeve dhe rendit të punës. A ka Plan për kompensimin e fatkeqësive nga vërshimet i cili ka ndodhur më 31 korrik 2014. Nën kryetari ka qenë, kryetari i komisionit dhe është mirë të na jep një përgjigje. Po ashtu edhe një dëmtim ka ndodhur më vonë dhe drejtori i bujqësisë ka dhënë një premtim për kompensim në vlerë prej 75 mijë €, prandaj duhet dhënë sqarime se kur do të bëhet ky kompensim?

Rexhep Kadriu- ne Komuna e Gjilanit, nuk kemi premtuar se do ta bëjmë pagesën e dëmeve nga vërshimet, por ne kemi thënë dhe kemi formuar komisione dhe i kemi vlerësuar dëmet dhe ia kemi dorëzuar partive opozitare raportin për të gjitha dëmet për të tri vërshimet që kanë ndodhur në Gjilan. Kërkesën e kemi bërë në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe presim përgjigje. Në momentin që Qeveria e Kosovës i paguan dëmet ne do ta bëjmë kompensimin për çdo dëm.

Nuk pati debatues për këtë pikë dhe kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.1

Aprovohet pika 2.1: Plani operativ emergjent për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.2. Miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunitetin fqinj në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Ismet Hajdini- unë propozoj që pika 2.2 dhe 2.3. të debatohen në bllok, sepse janë pika të ngjashme të rendit të punës.

Aprovohet kërkesa e z. Hajdini, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

Selvete Shurdhani- unë po e bëj një pyetje lidhur me këtë pikë të rendit të punës: “a e rëndën apo e lehtëson buxhetin e Komunës së Gjilanit iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal me komunat fqinje në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera pasi që drejtoria përkatëse ballafaqohet me një buxhet të limituar”?

Rina Ahmeti- unë në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së e përkrahi pikën 2.2 dhe atë 2.3 dhe sugjeroj të gjithë kolegët që ta përkrahin këtë pikë të rendit të punës, sepse arsyetimet i keni në materialet e juaja.

Isa Agushi- unë mendoj se ky bashkëpunim do të jetë në dobi të Komunës sonë dhe komunave tjera, sepse gjithmonë është thënë se bashkimi e bënë fuqinë. Nëse të gjitha komunat i dalin njëra tjetrës në ndihmë, atëherë përfutimet janë të dyanshme. Këto pika unë i përkrahi si ekspert i mbrojtjes, sepse është iniciativë qëlluar.

Izmi Zeka- mua po më bën përshtypje se këto dy pika ndoshta fare nuk ka pasur nevojë të vijnë Kuvend. Kryetari i Komunës me të drejtë dhe me ligj i ka të rregulluara kompetencat e tij dhe nuk e di se cila është arsyeja që iu ka bartë kjo përgjegjësi Kuvendit? Nëse hyjmë të kostoja financiare, mua më duket se çdo propozim e ka një kosto financiare. Edhe pikën që e aprovuam, ajo ka kosto financiare dhe i paska 300 faqe, por edhe 10 nëse i ka e ka një kosto financiare. Mirëpo kostoja financiare nuk po sillet asnjëherë, por ndoshta herëve të tjera të kemi kujdes që çdo propozim ose rregullore e ka një kosto dhe është mirë që të na sqarohet dhe ta kemi atë kosto. Mirëpo këto dy çështje nuk i kisha debatuar fare, sepse kryetari mund të ketë bashkëpunim të ndryshëm me komunat e tjera për çdo rast, qoftë të rrezikut ose ndonjë nevojë të veçantë.

Valentina Bunjaku- Rexhepi- këtë e parasheh LVL-ja, me ligj është e paraparë arritja e marrëveshjeve komunale dhe brenda komunale dhe votohet në Kuvend, sipas nenit 40 të LVL-së.

Nevzad Rushiti- pasi që Komuna e Gjilanit, është komunë regjionale në kuadër të komunave tjera dhe gjatë përvojës Komuna e Gjilanit ka bërë intervenime edhe në Novo Bërd, Kllokot, Ranilluk, Kamenicë etj. Ky propozimi i kryetarit që është propozuar, ne duhet t’i japim mbështetje, sepse ka nevojë për mjete teknike dhe të tjera dhe të gjitha këto duhet të mbulohen me një vendim të Kuvendit dhe këtu është qëllimi.

Nevzad Isufi- nuk e vë në dyshim se kompetencat e kryetarit janë edhe për bashkëpunim, por edhe unë mendoj se në vend të arsyetimit të shpjegimit të këtij qëllimi duhet të parashihet në të ardhmen që të jetë ai plan konkret se për çka është vendos që të bashkëpunohet? Këto do të ishin pika për të cilat mund të bashkëpunojmë, por askush nuk mund të jetë kundër, sepse të gjitha janë Komuna të Republikës së Kosovës. Unë mendoj se në vend të arsyetimit do të kishte qenë mirë që të jetë një plan konkret, por ndoshta do të bëhet në të ardhmen?

Shukrie Rapuca- edhe për mendimin tim këto dy pikë fare nuk ka pasur rëndësi të vijnë këtu, sepse me LVL-në janë të përcaktuara decidivisht të gjitha përgjegjësitë në nivelin lokal me komunat fqinje. Sa për dijeni e kam lexuar këtë ligj dhe ja se çka përcakton neni 37. pika 1.2 dhe 3 (në vijim citohet ligji). Çdo gjë është e përcaktuar me ligj, askush nuk e ndalon kryetarin për të marrë iniciativa për raste emergjente dh ligji përcakton qartë se çka duhet të ndërmerret?

Sadri Arifi-unë po pajtohem në shumë çështje që i tha zonja Rapuca, por ne zakonisht punojmë dhe funksionojmë si Kuvend në bazë të LVL-së. Decidimisht neni ka 40 i shpjegon funksionet të cilat i ka Kuvendi. Dhe një ndër këto thotë edhe arritjen e marrëveshjeve komunale dhe brenda komunale.

Shukrie Rapuca- sikur të kishte qenë kështu, atëherë kur të themelohet lista për anëtarë të Kuvendit do të duhej të propozohet lista prej të gjitha profesioneve, sepse për ndryshe do të kishim mbet këtu sikur shurdhmemec. Mirëpo jemi të gjithë nivelit për ta ditur se çka duhet sjell në Kuvend? Çdo gjë është e qartë fare dhe këtë pikë nuk kanë pasur nevojë të vijnë në Kuvend. Kjo është diçka sa për të thënë se po bëhet diçka dhe i aprovoni pasi i keni votat. Unë mendoj se as që ka pasur nevojë për ta bërë një shpenzim këtillë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.2. dhe 2.3

Aprovohet pika 2.2.; Miratimi i iniciativës së Kryetarit të Komunës për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunitet qfinje në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe pika 2.3. Propozim Vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndërkomunal me Komunitet qfinje në sferën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenojnë.

2.4. Propozim vendimi për formimin e Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të integritetit

Valentina Bunjaku- Rexhepi- përbërja e komisionit është 2 LDK, 1 PDK, 1 AAK dhe 1 LVV.

Avdyli Aliu- ky vendim për komisionin për Mbikëqyrje të zbatimit të planit të Integritetit, është një vendim i rëndësishëm dhe do të jetë i rëndësishëm edhe roli dhe detyra e këtij komisioni në vazhdim. Jo më larg se dje e kemi parë se Komuna e Gjilanit është informuar për miratimin e aplikimit të Gjilanit për Komponentin e llogaridhënies sociale, qëllimi i së cilës është angazhimi dhe rritja e pjesëmarrjes në vendim-marrje lokale, duke përmirësuar në këtë mënyrë integritetin dhe transparencën në llogaridhënie, efikasitetin e shërbimeve publike si dhe menaxhimin e aseteve publike. Në seancën e fund vitit e kemi pasur Planin e integritetit dhe e kemi aprovuar në Kuvend për trajtim dhe ndalim të korrupsionit (një dokument shumë të rëndësishëm).

Në emër të LDK-së, unë i kam propozimet për këtë Komision dhe këta janë: Refik Shala dhe Rina Ahmeti.

Bujar Nevzadi- në emër të PDK-së e propozojmë, zonjën Leonorë Bunjaku.

Selami Xhemajli- në emër të AAK-së e propozoj z. Ibish Ibishin

Nevzad Isufi- në emër të LVV e propozojmë zonjën Krenare Latifi

Aprovohet pika 2.4: Propozim vendimi për formimin e Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të integritetit, me 31 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

2.5. Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjatë (99 vite) për ndërtimin dhe vendosjen e Trafostacioneve 10(20) KW

Sadudin Berisha- para vetes anëtarët e Kuvendit e kanë një vendim për dhënie të pronës së Komunës në shfrytëzim në periudhën prej 99 viteve për nevojat e vendosjes së trafostacionit në kapacitet prej 10 dhe 20 kilowat. Ky propozim-vendim i ka kaluar të gjitha fazat procedurale nga kërkesa që është shtruar në drejtori dhe është dhënë vlerësimi ligjor në koordinim me DUMM dhe është debatuar në Komitetin për Gjeodezi dhe Pronë dhe në KPF. Unë kujtoj se ky është një akt formal për ta vendosur ky Kuvend. Prona edhe më tutje mbetet pronë komunale, titullari nuk ndryshon, por vetëm epet në shfrytëzim një sipërfaqe prej 38m²

Nuk pati debat për këtë pikë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.5

Aprovohet pika 2.5 e rendit të punës: Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjatë (99 vite) për ndërtimin dhe vendosjen e Trafostacioneve 10(20) KW, me 30 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

Pas kësaj pike anëtarët e Kuvendit në ora 12 shkojnë në një pushim deri në ora 13.30.

2.6 -Raporti i suksesit të nxënësve në fund të gjysmë vjetorit të parë 2015/16

Nazmi Musa- për raportin e suksesit të nxënësve në gjysmë vjetorin e parë raportojë, drejtori i Arsimit, z. Nazmi Musa, por të cilin raport të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë me shkrim në materialet e tyre të seancës.

Arben Mehmeti- e përshëndesim angazhimin e drejtorit të Arsimit, sepse tash e kemi një situatë krejtësisht të re në krahasim me të kaluarën e cila ka pasur keq menaxhim dhe për atë është bërë edhe ndërrimi i pushtetit. Problemet më të mëdha kanë qenë në fushën e Arsimit, kurse tash vërehet një përmirësim i dukshëm i gjendjes në arsim.

Gjithashtu duhet theksuar se DKA është një ndër drejtoritë më të suksesshme në nivel të Kosovës për nga menaxhimi dhe angazhimi i procesit mësimor dhe kjo është mirë për qeverisjen komunale duke përfshirë edhe opozitën. Në këtë raport e kemi vlerësuar edhe në komitetin e Arsimit dhe e kemi dhënë një vlerësim pozitiv, me ndonjë rekomandim të caktuar. Kemi kërkuar marrjen e ndonjë mase sa i përket numrit të madh të mungesave të nxënësve.

Gjithashtu kemi rekomanduar që në ato shkolla ku ka numër të madh të mungesave, ndaj atyre drejtorëve të merremi më tepër dhe të shikohet se ku qëndron problemi.

Gjithashtu kemi konstatuar edhe një fakt se mungesa më tepër ka në ato shkolla të cilat qeverisën nga PDK-ja dhe kjo është shqetësuese, sepse dikush mendon se ende është ai avazi i vjetër i qeverisë dhe duhet vazhduar në atë formën e asaj qeverisje pa llogaridhënie.

Në jemi në njohuri se janë bërë disa protesta në Shkollën “Thimi Mitoko”, por ato janë me motive politike, sepse të gjitha procedurat kanë kaluar për pranim të kuadrit, kurse anëtarë të komisionit më tepër ka pasur të opozitës se sa të pozitës. Mirëpo tash të dilet politikisht për ta akuzuar dike nuk është e ndershme dhe nuk duhet të keqpërdoren nxënësit për qëllime politike.

Në gjeneral ne e mbështesim punën e DKA-së, sepse vlerësojmë se është duke u punuar jashtëzakonisht shumë dhe mirë.

Izmi Zeka- unë nuk desha të merrem me këtë raport, por diskutimi i parafolësit më duket si i çuditshëm, sepse kanë kaluar dy vite, kurse ky ende merret me opozitën. Le të tregojë Arbeni se në cilin segment ka ndryshuar DKA, cilat ndryshime janë? A ka ndryshuar në cilësi? A ka ndryshuar në sukses të nxënësve ?

Sa i përket objekteve nuk kemi se çka flasim, ato ia kemi lënë të gatshme, por të thuhet se cilat janë aspektet konkrete. Është për habi të flitet jo drejtorët e pozitës, jo të opozitës? Nuk duhet t' i interesojë askujt kjo, sepse ata janë drejtorë të shkollave në nivel Komunal. Nëse saboton dikush (opozita), le të dalin haptas dhe ta thonë dhe ka ligje me të cilat mund të sanksionohet çdo drejtorë. Të etiketohet opozita në arsim, sikurse mund të thuhet zyrtarët që janë në Administratë Komunale janë 20-50 dhe nuk po e kryejnë punën dhe po sabotojnë, kjo është e palogjikshme. Kryetari i Komitetit të Arsimit të na tregojë konkretisht se ku kanë qenë defektet e mandatit të kaluar dhe cilat janë të arriturat e këtij pushteti në arsim?

Na i tregoni rezultatet e punës së juve, por në arsim ne i kemi vu themelet për shumëçka në Komunë të Gjilanit. Unë kërkoj prej drejtorit dhe jo prej Arbenit, sepse nuk është profesional në Arsim është jurist dhe nuk ka punuar asnjë ditë në Arsim dhe është e rëndë ky të na mbajë ligjëratat për arsim. Të na tregoni cilët janë ata drejtorë të PDK-së, por na tregoni edhe në Komunë cilët zyrtarë janë të PDK-së që po e sabotojnë punën? Ju preferoj që t' i kryeni punët e juaja dhe mos u merrni shumë me neve?

Arben Mehmeti- unë e kam një pyetje për z. Zeka se çfarë profesionalisti ka pasur dhe ka kur ka qenë zv/ ministër i MPB-së, kurse tash zv/ministër për Komunitete? Unë dy vite i kam përvojë në arsim, prandaj duhet pasur kujdes dhe duhet kërkuar falje. Mos të flasim për profesionalizëm, sepse prej niveleve më të larta gjendja është kështu, sepse politika të rangon edhe nëpër pozicione që nuk je profesional, por këto po ndodhin.

Dallimi nga qeverisja e kaluar me të tashmen është i dukshëm dhe ja vetëm një shembull: kur ka pasur nevojë për zëvendësime në qeverisjen e PDK-së, listën e ka bërë kryetari i Komunës dhe janë duke punuar në një periudhë prej 4-5 vite, kurse tash iu vije rendi për ta lëshuar procesin mësimor për shkak të konkurseve, sepse ai që i plotëson kriteret më mirë sipas konkursit pranohet në punë. Për zëvendësime asnjëherë nuk është shpallur konkurse, kurse ne tash për çdo zëvendësim e shpallim konkursin dhe këto janë ndryshime pozitive.

Nuk qëndron ajo se janë pranuar nga dy mësimdhënës për një vend pune.

Riad Rashiti- edhe unë po e bëj krahasimin e qeverisjes së PDK-së në Arsim dhe kësaj tash dhe është mirë të dihet dallimi. Në qeverisjen e PDK-së është hapur Universiteti i Gjilanit. Në qeverisjen e PDK-së janë ndërtuar 8 shkolla të reja, çerdhe dhe salla të sporteve. Tash ju edhe pas dy vite asnjë shkollë nuk e keni ndërtuar. Në qeverisjen e PDK-së nuk është anuluar asnjë konkurs ashtu siç ju ka ndodhur juve.

Nuk ka ndodhur asnjëherë që për javë të tëra mos të shpallet rezultati i konkursit për shkak të ndërhyrjeve që i ka pasur DKA. Nuk ka ndodhur në qeverisjen e PDK-së mos të ketë nxehje me javë të tëra nëpër shkolla. Në qeverisjen e PDK-së nuk ka pasur kaos për regjistrim të nxënësve nëpër shkolla. Në qeverisjen tonë ka pasur kritere, por ju i keni shkatërruar të gjitha këto kritere. Ne nuk ia kemi anuluar dhe humbur bursat studentëve, kurse në qeverisjen e PDK-së kjo nuk ka ndodhur, por nuk kemi pasur skandale në organizimin e ekskursioneve ashtu siç iu ka ndodhur juve, por edhe shumë skandale të tjera si me tender për transport të nxënësve dhe mungesë të energjisë elektrike për një shpenzim prej 10€. Nuk është mirë të bëhet një krahasim i cili nuk ka fare ngjashmëri në asnjë segment të arsimit.

Fehmi Sylejmani- unë dëshiroj që këtë debat ta zhvendosim dikah tjetër dhe jo në punën e DKA-së, sepse pikë e veçantë është raporti i suksesit të nxënësve dhe kryetari i Komitetit nuk ka qenë e nevojshme të hyjë në çështje të mbarëvajtjes së DKA-së, sepse në rend të ditës e kemi Raportin e suksesit të gjysmë-vjetorit të parë.

Sipas mendimit tim ky raport është i përfshirë në formë statistikore dhe krahasime nuk ka dhe nuk ka ndonjë analizë dhe ndonjë shqyrtim të duhur të këtij raporti dhe në radhë të parë nuk kemi analizë pse suksesi i nxënësve në shkollë të mesme është negativ 41% e që është një sukses shumë shqetësues dhe brengosës për të gjithë ne. Për këtë rast duhet të identifikohen arsyet dhe shkaqet pse ka ndodh kjo, ku janë arsyet? Gjithashtu DKA me Ministrinë e Arsimit duhet ta trajtojë suksesin dhe ta balancojë

suksesin me semestrin e parë dhe atij të dytë, sepse semestri i parë është shumë i shkurtër, kurse ai i dyti shumë më i gjatë. Unë mendoj se drejtori duhet të angazhohet me nivelet më të larta që gjysmë-vjetori i parë të vazhdojë deri më 15 janar. Po ashtu në raport vërehet se kemi mungesa, por në nivelin më të lartë shumë më tepër, në nivelin e lartë të mesëm më pak, kurse në nivelin fillor edhe më pak. Edhe për këtë duhet t'i gjejmë arsyet pse po na ndodhin këto?

Unë kam propozuar në Komitetin e Arsimit dy herë, por po iu njoftoj edhe juve kuvendarëve që të bëhet përgjegjës në mënyrë ligjore ose duke i rishikuar dispozita ligjore që përgjegjës për mungesa të paarsyeshme të bëhet prindi, sepse në të shumtën e rasteve prindërit janë fajtor pse fëmija nuk shkon në orën e parë ose të dytë në shkollë.

Po ashtu vërehet se në raport ka një numër të madh të zvogëlimit të numrit të nxënësve, niveli i ulët ka më pak, i mesmi pak më shumë, kurse niveli i mesëm i lartë edhe më shumë. Nga kjo shihet se çdo vit kemi nxënës më pak dhe kjo është një rënie drastike e natalitetit dhe për këtë arsyeje unë kam propozuar në komitet që të ketë shtesa fëmijërore dhe të ketë beneficione dhe të kemi fëmijë në të ardhmen më shumë. Në të kundërtën nuk do të shkojnë as 10 vite shkollat do të mbesin të zbrazëta ose do ta aplikojmë mësimin tërë ditë. Sa i përket drejtorëve, mendoj se nuk duhet t' i klasifikojmë drejtorët të PDK-së ose LDK-së ose LVV, sepse ata janë drejtorë që i referohen arsimit dhe i japin përgjegjësi DKA-së, kure përgjegjës është kryetari i Komunës i cili mund t' i shkarkojë në çdo moment. Në këtë raport nuk janë identifikuar shkaqet e mungesave, por tash në gjysmë-vjetorin e dytë duhet dal me rekomandime se si duhet vepruar më tutje. Në këtë gjysmë vjetor suksesi është negativ 41%, por në të dytin jam i bindur se nuk do të mbesin as 5%, prandaj nuk duhet lejuar këtë shpërputhje. Shqetësimi më i madh është te numri i madh i mungesave të shkollat e mesme, por edhe suksesi negativ.

Shukrie Rapuca- ne në Komitetin e Arsimit e kemi shqyrtuar këtë raport dhe e kemi dhënë vlerësimin tonë dhe vlerësimi i ynë ka qenë pozitivë sa i përket anës teknike.

Drejtori ka bërë edhe krahasime referuese me vitin e kaluar për të pasur mundësi për ta parë gjendjen reale se çka është pozitive, çka është më progresive në këtë vit?

Mirëpo ajo çka është me rëndësi është se ne sa i përket rezultatit të suksesit të nxënësve dhe është për t' i shqetësuar, është se kemi të bëjmë me një ngecja të suksesit të nxënësve nga viti në vit, por unë nuk po them se partia e ime, e atij ose këtij, por flas si mësimdhënëse në procesin mësimor. Nuk ka rritje të suksesit dhe ajo rritje është fare e parëndësishme 00.3% dhe shtrohet pyetja a është kjo për t' u krenuar?

Numri i mungesave është tejte i madh dhe vazhdon në këtë mënyrë si në vitet paraprake dhe këtë vit ka dallim vetëm për 60 mungesa, prandaj kjo shifër a është për t' u krenuar?

Çdo vit na përcjellin të njëjtat probleme kur është fjala për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, çdo vit na përcjellin këto probleme kur është koha e regjistrimit në klasat e dhjeta. Të dy këta faktorë ndikojnë në suksesin jo të mirë dhe çdo vit afër 1500 nxënës që regjistrohen në klasën e parë nuk e përfundojnë kurrë shkollën e mesme. Kjo armatë e tërë dikur bëhet shoqëri e të pashkolluarve.

Shkeljet e regrutimit me rastin e pranimit të kuadrit arsimor siç është edhe rasti i tashëm ndikon direkt në cilësi të dobët të procesit edukativo-arsimor. Këto të dhëna flasin se gjendja në arsim nuk është si duhet dhe me këtë trend të zhvillimit të arsimit nuk do ta arrijmë kurrë hapin të cilin e kanë arritur kombet në regjion. Këto të dhëna flasin edhe për një mobilizim të të gjithëve për ta ngritur cilësinë në arsimin, për ta ngritur efikasitetin në mësim, por për t' i ngritur edhe përgjegjësitë tona. Natyrisht se përgjegjësia i bie të gjithëve duke e përfshirë edhe veten, por përgjegjësia i bie më tepër atyre që e kanë marrë pushtetin dhe qeverisin në këtë mandat dhe kryesisht kryetarit dhe drejtorit të Arsimit.

Leonorë Bunjaku- unë po ndërlidhem vetëm me një pikë e të cilën zonja Shukrie nuk e tha, por i cili fakt më iritoj dhe më nxiti për ta marrë fjalën. Në Komitetin e Arsimit nga kryesuesi dhe kësaj here edhe nga drejtori është vërejtur dhe është brengosëse, sepse si po duket pushteti i tyre e ka humbur besimin edhe në veten e vetë, sepse po paragjykon për mungesat e arsyeshme. Si është e mundur që një shkollë të

ketë mungesa më shumë për shkak se qenka drejtori i PDK-së? A ka kuptim të thuhet kjo ? Të njëjtin gabim dhe të njëjtin gabim po e përsëritini. I keni gjobit mësimdhënësit të cilët kanë pasur mungesa të arsyeshme, kurse tani po i ndëshkoni edhe nxënësit të cilët mungojnë me arsyeje.

Unë e kam thënë në komitet nëse një prind vije te kujdestari i klasës dhe e arsyeton mungesën e fëmijës, ato janë të arsyeshme nëse prindi e arsyeton. Mirëpo të thuhet se drejtori i PDK-së është fajtor për mungesat e nxënësve, kjo nuk ka kuptim!?

Ajo që duhet përmendur është se në mënyrë jo legjitime, jo profesionale dhe jo korrekte po i vendosni njerëzit përgjegjës, si në komitete dhe pozita të tjera, kurse kryesuesi i Komitetit duhet të shkojë në një pozitë ku e meriton. Në këso pozita duhet pasur kujdes dhe zgjedhur njerëzit sa më profesional të cilët mund ta kryejnë atë obligim me përkushtim më të madh në mënyrë që të kemi rezultate sa më të mira.

Arben Maliqi- siç po shihet mjerimi i kësaj shoqërie më së miri po reflektohet në fushën e arsimit, PDK, LDK, AAK dhe LVV. Për këtë arsyeje gjendjen e arsimit në nivel komunal po shihet shumë mirë si e kemi? Jemi në atë nivel që arsimin definitivisht duhet ta depolitizojmë dhe të ecim përpara për hirë të fëmijëve tanë dhe për hir të gjeneratave të reja. Mirëpo po kthehem te raporti dhe shihet se në raport në gjysmë vjetorin e parë gjithmonë suksesi është më negativ dhe ky është fakt. Suksesi është më negativ, sepse profesorët janë më dorështrënguar dhe për këtë arsyeje edhe ky sukses që e tha z. Sylejmani është në këtë nivel. Unë mendoj mendoj ...(në këtë çast z. Maliqi e ndërpreu fjalën, sepse dikush pëshpëriste nga ulësja(si duket drejtori i Arsimit) dhe në shenjë revolte nuk e përfundoi diskutimin e tij).

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ka të drejtë z. Maliqi, sepse kur flitet për arsimin, drejtori i Arsimit duhet të dëgjoj.

Arben Mehmeti- drejtori i Arsimit duhet të dëgjoj kur ka diçka përmbajtjesore në këtë aspekt. Këtu jashtëzakonisht janë shtruar mirë të njëjtat çështje të cilat janë shtruar edhe para dy vite. Zonja Leonorë edhe para dy vite ka diskutuar të njëjtën çështje dhe e ka thënë se je profesional për ta udhëheq Komitetin e Arsimit, por pas dy vite e diskuton të njëjtën temë. Mirëpo del një organizatë që merret me vlerësimin e punës së komiteteve dhe këtë kryetar joprofesional e vlerëson me notën më të lartë.

Sa i përket menaxhimit, unë po habitem me zonjën Leonorë, sepse ajo më mirë do të ishte të merret me punët e veta si anëtare e komitetit e që në çdo kohë bie në kundërshtim me vendimet e komiteteve dhe Kuvendit. Ne e kemi një rregullore të cilin e kemi aprovuar në Kuvend dhe sipas kësaj rregulloreje nuk lejohet mbajtja e kurseve private, por e njëjta për pa u shqetësuar fare se mbi çfarë baza është duke e shkelur ligjin?

Unë në këtë drejtim pajtohem me Leonorën, sepse DKA nuk është duke e kryer punën mirë në këtë aspekt. Në këtë aspekt DKA ka qenë deshtë që ata që merren me edukatë fizike dhe gjuhë angleze dhe me tjerat e që nuk respektojnë vendimi e Kuvendit,(është fjala për kurse private), kurse DKA sot nuk raporton dhe nuk e ka marrë asnjë vendim për ta suspenduar dike që i shkel vendimet e KK-së. Nëse drejtori i Arsimit nuk merr veprime të duhura në këtë aspekt, unë do të dal në anën e opozitës dhe do të jem kritik ndaj drejtorit.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- unë jam për t' i monitoruar komitetet dhe është e vërtetë se Komiteti i Arsimit shkëlqyeshëm e ka kryer punën e vetë dhe ku është ajo e mirë në këtë mënyrë të funksionojnë edhe komitetet e tjera?

Leonorë Bunjaku- me gjithë respektin për kryesuesin e Komitetit të Arsimit, por nuk e ka ditur se aq shumë qon peshë ajo punë dhe bëhet ky debat. Me sinjeritet dhe para Kuvendit po deklaroj se Leonorë Bunjaku nuk posedon kurs privat, por punoj me një kurs privat të akredituar i vetmi në Gjilan dhe i cili të

gjitha proceduat ligjore i respekton dhe i përgjigjet. Për këtë arsyeje mua më lejohet që të punoj me një orar të shkurtuar kurdo që unë kam kohë. Nuk jam duke punuar në kurs privat personal, por në një kurs të akredituar.

Punët e mia në Gjimnazin “Xhavit Ahmeti” me plotë përpikëri dhe me plotë profesionalizëm i kryej dhe me ligj qëndroj mirë dhe nuk brengosem fare për atë se kush çka thotë? Unë e thash se në krye të Komitetit të Arsimit duhet të jetë një njeri i cili është në rrjedhë të procesit edukativo-arsimor.

Arben Mehmeti- le të deklarohet profesoresha se a ka ndonjë nxënës të vetin nëpër kurse. Ndonjë nxënës që iu jep mësim në shkollë dhe në të njëjtën kohë edhe i vijon mësimet në kurs. Kjo është e ndaluar rreptësisht me rregullore të Kuvendit. Me këso raste duhet të merret DKA, sepse nuk qëndron ajo se unë nuk posedoj me kurse privat personal, por punoj me një kurs privat me të njëjtit nxënës.

Ne këto i kemi ndaluar me një rregullore, sepse kjo është keqpërdorim i punës së mësimdhënësve. Unë kërkoj nga DKA që të merret me këso raste, sepse në vazhdimësi po shkelet një vendim i këtij Kuvendi.

Leonorë Bunjaku- për çdo informatë çdo kujt që i intereson, lirisht mund të del dhe të bëjë pyetësor dhe të shkojë në shkollë dhe në kurs është i mirëseardhur për t’u njoftuar me procedurat se si pranohen nxënësit e Komunës së Gjilanit në atë kurs? Aty fillimisht bëhet testimi dhe vlerësimi se për cilin nivel janë nxënësit

Mirëpo nëse mua më vjen ndonjë nxënës i imi ajo është zgjedhje e tij, por nëse unë e kam kërkuar ose obliguar që të vijë, urdhëroni dhe faktori këto veprime antiligjore siç po i quani.

Shukrie Rapuca- edhe kryesuesi i Komitetit të Arsimit ka qenë prezent kur ne anëtarët e Komitetit të Arsimit në opozitë i kemi dhënë lëvdata drejtorit të Arsimit për iniciativën e tij që këto kurse private të mbyllen njëherë e përgjithmonë, por ja që drejtori nuk e ka zbatuar këtë propozim ose sugjerim!?

Lëvdata drejtori ka marrë bukur të mira nga ne dhe kjo ka qenë në shtytje për pozitën, sepse opozita e ka përkrahur fuqishëm.

Mirëpo ajo çka po flitet për Leonorën nuk mund të rrijë e qetë për shkak të etikës sime morale edhe si kolege dhe si femër. Unë p’iu njoftoj se Leonora që dy vite me radhë shpallet profesoresha më e mirë së bashku me klasën e saj në shkollën Elitë – Gjimnaz. Kjo tregon për aftësitë e saj dhe cilësitë e saj si profesioniste.

Sa i takon shkollës ku ajo mban kurs, këtë e përcakton ligji dhe nuk mund të merremi me këtë, por puna e saj dallon nga ato kurset private të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret.

Ismet Hajdini- zonja kryesuese të lus që t’i përmbahemi rendit të ditës, sepse si pikë e rendit të punës është sukcesi dhe nuk janë në rend dite kurset dhe çështjet personale. Kaluan 30 minuta dhe ne po maltretohemi me gjëra që nuk janë në rend të punës.

Arben Mehmeti- unë po e kundërshtoj z. Ismetin, sepse të gjitha këto që po fliten këtu kanë të bëjnë me njëfarë lloj sukcesi dhe nuk është hera e parë që po dëgjoj nga kolegët e të cilëve nuk i pëlqejnë disa tema dhe nxitojnë që sa më parë të përfundojnë. Askush nuk është duke i ndal për të dal jashtë sallës, por nuk ka të drejtë askush të më thotë mos fol, sepse ne jemi në Kuvend.

Jashar Jashari – unë e përshëndes pasqyrimin e raportit të suksesit të nxënësve për gjysmë vjetorin e parë të vitit 2015/16. Mirëpo unë e kam një kërkesë për DKA-në përkitazi me një iniciativë që në ardhmen të bëhet përzgjedhja e nxënësit më të mirë në nivel të qytetit. Mua më ka rasti për ta parë një rast të tillë në Shqipëri.

Fotoja e nxënësit më të mirë është vendosur nëpër bulevarde dhe sheshe të qytetit, prandaj është mirë që ky shembull të praktikohet edhe te ne, sepse nxënësit do të motivohen për të qenë sa më të suksesshëm.

Nevzad Isufi- unë fillimisht e mora fjalën për çështjen e konkursit për të cilin posa është shpall vendimi, prandaj pyetja ishte edhe më herët nga kolegët, pse është vonuar shpallja e listës së të pranuarve e po ashtu lidhet edhe me suksesin e nxënësve. Po ashtu e kam një vërejtje rreth menaxhimit të fillimit të vitit shkollor, por edhe të gjysmë vjetorit të dytë në këtë rast, sepse ky gjysmë vjetor ka filluar jo mirë dhe si rezultat i kësaj janë bërë mungesa të shumta të nxënësve dhe arsimtarëve, sepse në disa shkolla ka munguar ngrohja dhe ka ndikuar në rritjen e numrit të mungesave. Për këtë arsyeje drejtoria duhet të ketë një qasje tjetër sidomos kur është fillimi i gjysmë vjetorit të dytë i cili fillon në mes të dimrit. Me të drejtë ishte edhe propozimi i çështjes së lëvizjes së gjysmë vjetorit të dytë, sepse disa shkolla kanë pasur humbje të mëdha të orëve pikërisht për shkak të ngrohjes.

Po ashtu e kam edhe në pyetje e cila lidhet me vonesën e rezultatit të konkurseve e cila vonesë ka shkaktuar edhe humbje të orëve të mësimi. Pse ka ndodhur kjo vonesë dhe a ka ankesa për këtë rast dhe sa janë ato dhe a janë shqyrtuar nga DKA.?

Fehmi Sylejmani- unë e përkrahi propozimin e doktorit (Jashar Jashari) i cili ishte shumë i qëlluar, por unë këtë e kam thënë edhe në Komitetin Arsimit që të shpërblen edhe mësimdhënësit më të mirë edhe atë sidomos kur nxënësit marrin pjesë në gara. Dua t' i bëjë me dije se një nxënëse që ka qenë fituese e kampionatit mbarëkombëtarë (Genta Latifi), sot është studente në Gjermani dhe ka aplikuar për ndihmë në Komunën e Gjilanit (te kryetari), por nuk iu ka refuzuar ndihma. Mendoj se këtyre talenteve dhe kuadrove duhet bërë gjithçka Komuna për t' i ndihmuar.

Sadullah Kadriu- e përgëzoj raportin e drejtorit i cili ishte mjaft i qëlluar dhe i përgatitur mirë, por e kam një pyetje e cila siç dihet vitin e kaluar ka qenë një migrim jashtëzakonisht të madh nga qytetarët së bashku me fëmijët e tyre, prandaj a ka mundësi të dihet numri i atyre nxënësve që janë rikthyer dhe sa është përafëruar numri i nxënësve para dhe pas migrimit?

Nazmi Musa – i falënderoj të gjithë diskutuesit, pavarësisht mendimeve që i kanë shpreh, sepse është plotësisht e drejtë e tyre, ndonëse dikush është mënjeluar nga tema dhe qëllim i debatit, sepse po të ishte kjo temë kaq e gjerë, atëherë do të isha i përgatitur për të dhënë edhe përgjigje të tjera.

Po kaloj në temë dhe po theksoj se vetëm njëherë dhe po e përsëris se vetëm njëherë kam bërë krahasime në mes të kësaj qeverisje dhe së kaluarës. Unë e kam thënë se cilën gjendje e kam marrë dhe nuk kam dëshirë t' i kthehem kësaj teme përsëri. Nëse kthehem prapa vetëm bëjmë polemika të kota, sepse koha i sjell ndryshimet dhe në bazë të kësaj këto dy vite dukshëm janë më të mira dhe ka cilësi. Mirëpo edhe ai që do të vijë pas meje do të ik larg prej meje, sepse gjithmonë dhe gjithherë rruga është e hapur për suksese.

Ne sot kemi të bëjmë me analizën e suksesit që është bërë nëpër secilën shkollë, kurse raportet e tyre vijnë në drejtori dhe kjo është përmbledhje e analizave që është bërë nëpër shkolla e që ka të bëjë me statistikën, vlerësimet dhe me ngritje të cilësisë. Mirëpo të thuash se nuk ka ngritje cilësore, ku mesatarja e secilës dhe secilit nivel është prej notës 3 deri në notën 4 dhe 5, nuk është ky sukses?

Ne që punojmë në arsim i gëzohemi shumë rezultatit kur kalon përqindjen 2.5 dhe themi se jemi mirë, por edhe testet e jashtme kur të dalin me një sukses të tillë janë të pranueshme.

Pas analizës që e kemi bërë dhe diskutimin që e kemi pasur me drejtorët e shkollave, vlerësimi që iu është dhënë atyre, vërejtjet që janë bërë në mënyrë zyrtare dhe kolegjiale, janë vërejtje të cilat kanë të bëjnë me ngritje të cilësisë. Edhe zonja Leonorë e dinë shumë mirë se menjëherë në fillim të vitit shkollor i kam vizituar disa shkolla, por edhe klasën e saj. Kur tash kjo zonjë i thekson mungesat si dobësi, më lejohet ta bëjë një pyetje edhe unë: “ pse pikërisht klasa e sajë i ka lëshuar orët në mënyrë kolektive”? Për këtë rast zonja Leonorë cilat masa i ka marrë ndaj asaj klase? Nëse një klasë (30) nxënës,

nëse i lëshojnë orët qoftë edhe një ditë, patjetër se ngritët numri i mungesave. Nuk po them këtë si akuzë, por nxënësit e nivelit të arsimit të lartë ndikojnë shumë e shumë rrethana të tjera të cilat nuk krahasohen me nxënësit e klasës së parë në shkollën fillore. Suksesi i nxënësve të klasës së parë dhe me një mësues-e që punon 5 vite me ata nxënës (me një ndërhyrje të prindërve, duke i thënë të lutem mësues-e, mos ma hidhëro gocën apo djalin, sepse po qanë dhe po dëshpërohet në shtëpi nëse nuk kalon me 5 (pesë), kurse mësuesi-ja e vlerëson me pesë vazhdimisht, por sapo të dalin në ciklin e dytë e që ka të bëjë me shumë mësimdhënës, menjëherë bie shkalla e vlerësimit dhe e Dijes, kurse mos të flasim kur të vijë në klasën e X dhe XII.

Edhe një çështje po e them se Ministria e Arsimit nuk merr asnjë aktivitet që ka të bëjë me procesin mësimor në shkollë, me kualifikimet, me trajnimet dhe me programet e reja e që Gjilani nuk është në mesin e komunave dhe në qoftë se janë dy e tri, katër apo pesë, Gjilani është në mesin e tyre. Unë iu pyes pse e thërrasin Gjilanin?

Këtu nuk ka të bëjë as me LDK-në, as PDK-në se arsimin të gjithë e dimë dhe themi është i depolizuar, kurse në anën tjetër edhe të LDK-së dhe PDK-së qoftë edhe në prapavijë për pa u implikuar nuk mbetet asnjëherë.

Korrigjoni veten dhe veprimet e juaja dhe ndërhyrjet në fushën e arsimit, sepse këto ndërhyrje mund t' i sjellin probleme shkollës ashtu si në Shkollën "Thimi Mitko". As nuk ka faj drejtoria, as komisioni, as unë si drejtor, por faj ka konkursi ku garojnë 586 kandidatë dhe çdo kush që hyn në konkurrencë duhet pasur parasysh se ekziston edhe rreziku i eliminimit. Ajo mësuese e cila ka punuar 4 vite për pa shpall konkurs patjetër është dashtë të matet dhe të mos hidhërohet pse ka ardhur kandidatja tjetër më e kualifikuar.

Sot manipulohet me fëmijë 6 vjeçar, sepse ata dinë të shkruajnë edhe parulla, ne themi nuk kemi nxehje, kurse ata dalin në oborr dhe i mban dikush ligjërata dhe i thërret mjetet e informimit për vetëm të një interesi personal. Mandej në këtë rast ka dal edhe njeriu i cili nuk e ka pasur të drejtën për ta sjell fëmijën në këtë shkollë. Ju e dini pse janë bërë zonat, a janë bërë për nxënësit e asaj zone?

Dikush po thotë i kemi bërë 8 shkollë të reja, por ne nuk kemi nevojë t' i bëjmë 8 shkollë të reja dhe të barazohemi, por në këtë rast unë e shtoj pyetjen se a është bërë planifikimi i mirë i shkollave. Më mirë do të ishte që një shkollë të ndërtohet afër Tregut dhe mos të grumbullohen 2000 nxënës në qendër të qytetit, apo të ndërtohet shkollë në Selishtë me 5 nxënës.

Dëshiroj t' i lus të gjithëve që të jemi të organizuar sipas ligjit dhe sipas rregulloreve. Aty ku unë Nazmi Musa e kam shkelur ligjin mos më kurseni dhe të gjithë ju nëse intervenoni për ta shkel ligjin, unë nuk pajtohem dhe do të reagoj haptas. E drejta dhe përkrahja më e mirë e imja është ligji, prandaj mos hezitoni dhe ma bëni me gisht kur shkelet ligji. Mirëpo jo të më thotë dikush se janë pranuar dy mësimdhënës në një vend pune! Kush e ka bërë këtë dhe ku janë dy arsimtarë në një vend pune? Tregoni ku dhe cili?

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.6 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.6 e rendit të punës: Raporti i suksesit të nxënësve në fund të gjysmë vjetorit të parë 2015/16 me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan

Pas kësaj pike, kryesuesja i propozon 10 minuta pushim

2.7. Raportet e punës së Komiteteve të KK-Gjilan për vitin 2015

Sekretaria konstatoi se në sallë janë 27 anëtarë të Kuvendit.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- KPF gjatë vitit 2015 i ka bërë 70 rekomandime, Komiteti për Shëndetësi i ka mbajtur 13 takime dhe 9 rekomandime, Komiteti për Komunitete 11 takime dhe 1 rekomandim,

Komiteti për Planifikim Urban 5 takime dhe 4 rekomandime, Komiteti për Shërbime Publike 6 takime dhe 5 rekomandime, Komiteti për Arsim i ka mbajtur 13 takime dhe i ka nxjerr 6 rekomandime, Komiteti për Gjeodezi dhe Kadastrë i ka mbajtur 10 takime dhe i ka nxjerr 9 rekomandime, Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport 7 takime dhe i ka propozuar 6 rekomandime, Komiteti për Zhvillim Ekonomik 7 takime dhe i ka propozuar 5 rekomandime, Komiteti për Barazi Gjinore i ka mbajtur 7 takime dhe nuk e ka propozuar asnjë rekomandim, Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar i ka mbajtur 3 takime dhe i ka propozuar dy rekomandime, Komiteti i Ekspertëve 3 takime dhe ka nxjerr një rekomandim dhe Komisioni për Emërtimin e rrugëve 50 takim, KKSB 7 takime dhe debate me qytetarë janë mbajtur 7 takime dhe debate për rregullore, janë mbajtur 6.

Kjo është një punë e frytshme e trupave ndihmëse të KK e që e shfrytëzoj rastin për t' i falënderuar të gjithë anëtarët e komiteve për punën e frytshme dhe të suksesshme që kanë bërë gjatë vitit 2015, duke dëshiruar që ky vit të jetë edhe më i suksesshëm.

Nevzat Isufi- ne seancën e kaluar ne si grup i anëtarëve të Kuvendit, kemi kërkuar që t' i kemi planet e punës për të gjitha komitetet. Kjo ka qenë kërkesë dhe kjo nuk është realizuar dhe për dy vite nuk janë dorëzuar asnjëherë. Ju po e dorëzoni raportin, por planet e punës as që i kemi parë të këtyre komiteve. Për mendimin tim këto raporte kanë shumë mangësi dhe ka raport që nuk iu është dorëzuar Kuvendit, por iu është drejtuar kryesueses. Mandej në shumë raporte në vend se të flitet për punën që është bërë flitet për kompetencat që i ka komiteti dhe nuk flitet për punën konkrete të komitetit të caktuar. Unë do të jem edhe vetëkritikë, sepse në Komitetin ku jam pjesëmarrës dhe e drejton kryesuesja, nuk e kemi raportin e punës së KPF-ë, sepse para se të flasim për raportet e të tjerëve në radhë të parë duhet të flasim për raportin tonë.

Po ashtu nuk janë të precizuara punët që janë kryer, kurse rekomandimet nuk janë të specifikuar mirë. Unë do të veçoja një raport i cili më është dukur pak më i mirë, sepse kemi pasur çështje financiare dhe ai është raporti i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i cili për dallim nga të tjerët më duket më serioz. Mendoj se këto raporte duhet të jenë më serioze, por para se t' i shohim raportet ka qenë dashur t' i shohim planet e punës së komiteve për ta ditur se çka ka në plan ai komitet për një vit të caktuar. Në raporte nuk kemi rekomandime të qarta dhe nuk kemi shqyrtim të këtyre raporteve në radhë të parë nga komitet.

Ka komitete të cilat i kanë planifikuar 10 takime, por i ka mbajtur vetëm gjysmën, prandaj kjo nuk mund të quhet sukses, ju mund ta quani sukses, por unë nuk mund ta quaj këtë sukses.

Avdyli Aliu- unë i falënderoj të hartuesit e raporteve të komiteve dhe shumica e hartuesëve (kryesuesit), janë prezent këtu dhe sa i përket KPF-së, puna këtij komitetit e paraqet edhe punën e Kuvendit. Ashtu si po thuhet i bie sikur Kuvendi duhet t' i jap raport Kuvendit, sepse ju e dini që KPF i paraprin punës së Kuvendit dhe çdo punë e Kuvendit duhet të kalojë nëpër KPF.

Sa i përket komiteve tjera i falënderoj për punën që e kanë bërë të cilët na kanë dhënë ndihmë të madhe edhe si ekzekutiv, por edhe si legjislativ. Ne gjatë këtij viti i kemi formuar edhe dy komitete të reja si është ai për Barazi Gjinore dhe ai për Bashkëpunim Ndërkufitar me të cilët komiteti i kemi mbuluar dy fusha shumë të rëndësishme. Gjithashtu edhe Komiteti Konsultativ i Ekspertëve është zgjedhur me konkurs e të cilët kanë bërë punë të mirë, por raportin e komiteti të Ekspertëve dhe të atij për Bashkëpunim Ndërkufitar nuk e kemi për arsyeja të ndërrimeve që janë bërë në këto dy komitete. Mirëpo shumë shpejt do të vijnë edhe raportet e tyre.

Sa i përket planeve të punës së komiteve, nuk e di a e kemi të njëjtin material me parafolësin tim, por bashkë me raportin e kemi edhe planin e punës së komiteve, për vitin 2016.

Nevzat Rushiti- gjatë hartimit të panit të punës së Kuvendit, ne jemi marrë vesh që komitetet së pari ta dorëzojnë raportin e vitit 2015 për ta ditur se çka është punuar, ashtu si është bërë sot.

Mirëpo për muajin shkurt ka mbetur për t' u dorëzuar planet e këtij viti (2016). Nuk duhet nxjerr se për komitetet jemi marrë vesh sipas këtij parimi. Unë mendoj se cilësia e punës së kuvendit varet nga puna e komiteve dhe rekomandimet që janë dhënë janë aprovuar në këtë Kuvend.

Nëse mund të thuhet nga përfaqësuesi i VV që është rekomanduar diçka dhe nuk është shqyrtuar në Kuvend le ta thotë konkretisht, sepse ashtu si tha kolegu po i bie se gjëja se nuk kemi punuar asgjë.

Nevzad Isufi- unë nuk e thash se nuk është punuar asgjë, por e thash se ka vend për kritikë. Ka vend për shqyrtime, sepse për planet që po flisni ju, unë i kam printuar(shtypur) dhe nuk i keni dorëzuar ju që e keni pasur për detyrë. Unë vetë i kam shtypur edhe planet e vitit 2016, por i kam edhe raportet dhe nuk e keni dërguar ju që e keni pasur për obligim. Po flasim për diçka konkrete dhe nuk e mohova punën, po thash se ka vend për t' u punuar shumë më seriozisht. Nuk mund të thuhet se po i raporton Kuvendi-Kuvendit, por një pjesë e Kuvendit po i raporton Kuvendit dhe unë e kam për nder për t' i raportuar shumicës së kolegëve këtu.

Krenare Latifi- unë po e marrë fjalën dhe po ndërlidhem me Komitetin për Shërbime Publike, sepse gjatë vitit të kaluar i kemi mbajtur vetëm 5 takime. Për këtë arsyeje kërkoj nga kjo drejtori (Shërbime Publike), të mbahen të gjitha takimet, të jenë të rregullta dhe aq sa janë të parapara, por edhe të jenë konstruktive. Pa asnjë tendencë po e them se e patëm edhe takimin e parë të këtij viti i cili më tepër ishte gjysmë takimi, sepse edhe anëtarët e komiteti munguan në atë takim. Kërkoj që anëtarët e komitetit të jenë më të përgjegjshëm.

Isa Agushi- unë jam kryesues i Komiteti për Shërbime Publike dhe ne e kemi mbajtur mbledhjen e parë të këtij komiteti, por kuorum kemi pasur sepse 4 anëtarë kemi qenë prezent prej 7 sa i ka komiteti. E dyta ne i kemi mbajtur 5 takime dhe i kemi bërë 2 rekomandime dhe këtu nuk ka të keqe asgjë dhe kemi kaluar, mirë gjatë vitit që shkojë, kurse kërkesa ka aq të shumta që as ne as Kuvendit nuk mund t' i realizojë.

Fehmi Sylemnani- edhe unë i kam lexuar raportet dhe mendoj se raportet nuk janë të hartuara ashtu siç duhet, sepse këto raporte kanë shumë mangësi. E para punë që duhet bërë ka qenë dashtë të raportohet se cilat tema janë diskutuar, cilat tema kanë mbetur për pa u diskutuar dhe cilat rekomandime janë bërë? Si shembull po e marrë raportin e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport e veçmas për sport nuk e kemi asnjë temë dhe asnjë falë për gjendjen e infrastrukturës sportive, apo gjendjen në fushat e sportit në Komunën e Gjilanit. Nuk kemi asgjë të shkruar për gjendjen financiare të klubeve sportive, nuk kemi tema për masivizimin e të rinjve në sporte dhe disiplina të ndryshme sportive. Nuk kemi tema për ngritjen e cilësisë së sportit dhe nuk kemi projekt-rregullore për zgjedhjen e sportistit në Komunën e Gjilanit edhe pse ka përfunduar viti 2015 dhe Gjilani ende nuk e ka zgjedhur sportistin më të mirë. Ju tash po thoni se është në rregull? Nëse mendoni kështu, atëherë nuk jeni duke i parë këto gjëra ose nuk dëshironi për t' i parë!? Unë mendoj se të gjitha këto raporte kanë mangësi në përpilim më shumë, sepse në bazë se si duhet të bëhen raporte nuk janë.

Krenare Latifi- unë nuk e thash se është shkelur rregullorja, por me rregullore është që të mbahen gjithsej 12 seanca dhe kërkoja të jenë më të përgjegjshme dhe më konstruktive.

Isa Agushi- janë të parapara për t' u mbajtur 12 seanca, por nëse kemi material, nëse nuk kemi material nuk mund t' i mbajmë 12 dhe i mbajmë 6 ose 7 dhe krejt kjo vare prej materialit dhe sipas nevojës.

Nuk pati debatues të tjerë, kure kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.7

Aprovohet pika 2.7: Raportet e punës së Komiteteve të KK-Gjilan për vitin 2015, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, 2 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan.

2.8. Raporti vjetor i Departamentit të Prokurimit për Kontratat e nënshkruara Publike

Sali Kçiku- për pikën 2.8 të renit të punës, raportoi drejtori i këtij departamenti, z. Sali Kçiku e të cilin raport, anëtarët e Kuvendit e kanë edhe me shkrim në materialet e tyre të seancës.

Jakup Bajrami- e dëgjuam raportin e drejtorit dhe në emër të anëtarëve të Kuvendit të LDK-së e kemi pasur edhe takimin e rregullt dhe e kemi vlerësuar edhe këtë raport të këtij departamenti dhe të gjitha analizat që i kemi bërë në aspektin financiar shihet se është bërë një punë shumë e madhe në aspektin e investimeve. Shumë herë kemi pasur edhe vërejtje dhe sugjerime, por Ligjin e prokurimit nuk e njohim edhe ne si delegatë ashtu si duhet, sepse duhet të jenë edhe të licencuar dhe krejt atë që mund ta themi si LDK, ne e mbështesim këtë raport në bazë të dhënave që i kemi dhe në bazë të punëve të cilat janë kryer në terren.

Mirëpo kërkesat që paraqiten në terren dhe nevojat për infrastrukturë janë larg dëshirës, por me ato mjete që i kemi pasur, kemi bërë investime të mjaftueshme dhe për këtë arsyeje e përkrahim këtë raport.

Mizafere Ismaili – edhe unë e përkrahi drejtorin e Departamentit të Prokurimit dhe unë e përgëzoj për këtë raport dhe i dëshiroj dhe i uroj punë të suksesshme edhe më tutje.

Riad Rashiti- ne si opozitë dhe unë në emër të grupit opozitar të PDK-së t’i japim vlerësimet tona për këtë raport i cili është përgatitur për vitin 2015.

Së pari të Plani i punës së prokurimit është mirë drejtori të na e shpjegojë se cili ligj po e ndaluaka për ta prezantuar dhe për ta paraqitur në Kuvendin e Prokurimit kur ne jemi të sigurt se kjo është obligim ligjor për ta prezantuar Planin e secilës drejtori e sidomos të asaj që ka për obligim për ta shpenzuar buxhetin e Komunës.

Unë po filloj një nga një t’i theksoj shumë shkelje ligjore dhe procedurale e që janë bërë në aktivitete të shumta të prokurimit gjatë vitit të kaluar me ç’rast është dëmtuar rëndë buxheti i Komunës së Gjilanit. Përveç neve që ka dhënë vërejtje për mënyrën se si i ka kryer punët ky sektor, vlerësime kanë dhënë edhe institucionet e shumta të pavarura e që janë më profesional se ne. Gjatë vitit të kaluar i kemi rastet kur Auditori i Përgjegjshëm ka dhënë vërejtje për mënyrën si është shpenzuar buxheti për vitin 2014 dhe jo 2015. Kemi anulime të tenderëve nga Agjensioni Kundër Korrupsionit e cila i u ka drejtuar Zyrës së Prokurimit dhe kryetarit të Komunës që t’i anulojë këta tender, sepse janë bërë veprime që kanë qenë kundërligjore për barazi dhe diskriminim të bizneseve. Është edhe një vlerësim tjetër që po ashtu e ka dhënë edhe Agjensioni Kundër Korrupsionit për rastin tenderit për rastin e pajisjes me barna dhe pajisje tjera mjekësore për nevojat e QKMF-së.

Me këtë rast kriteret kanë qenë diskriminuese duke favorizuar operatorët e caktuar ekonomik dhe në të njëjtën kohë i ka diskriminuar të tjerët, sepse ky aktivitet i prokurimit nuk ka qenë i planifikuar paraprakisht nga autoriteti kontraktues. Për shumë anulime të tenderëve, drejtori nuk e tha asnjë fjalë.

U përmend se OSHP i ka anuluar vetëm dy tenderë e që kanë pasur të drejtë, por ne i kemi shënimet tona se janë anuluar shumë tenderë të tjerë nga OSHP. U përmend vlerësimi i mirë pozitiv sipas juve që kinse KDI ai paska bërë Komunës së Gjilanit. Shkurtimisht po e lexoj një reagim të cilin e ka bërë KDI për këto deklarime publike që i keni bërë ju në media publike: “Instituti Demokratik i Kosovës i ka quajtur të pabaza deklaratimet e Komunës së Gjilanit se gjëja kjo Komunë është radhitur si më e mira në nivel vendi për korrektësi dhe zbatim të ligjit” Mirëpo KDI thotë për Komunën e Gjilanit: se ka shfaqur tendencë për të devijuar nga raporti i indeksit të transparencës”

Sipas KDI-së puna e Zyrës së Prokurimit ka probleme serioze dhe se për këtë KDI i ka të evidentuara dy raportet e saj. Me emër Diana Krasniqi e ka thënë se Komuna e Gjilanit është e njohur me numrin e madh të tenderëve me procedurë të mbyllur dhe të atyre që janë anuluar. Nuk më është e qartë si po e paraqitni pozitivisht këtë vlerësim të KDI-së, kur ata iu kanë demantuar publikisht.

Sa i përket vlerësimeve tona ne edhe më herët i kemi ngrit shqetësimet për rritjen enorme të shpenzimeve që është duke u bërë nga buxheti komunal për projekte të tenderëve të njëjtë që kanë dhënë kjo Komunë në vitet e kaluara. Unë po e lexoj disa, por jo të gjitha:

Te mirëmbajtja verore e rrugëve ju keni kontraktuar një kompani sikurse edhe këtë vit në vlerë prej 127 mijë €, kurse këtë vit në dhjetor të njëjtit ia keni dhënë tenderin për 596 mijë € dhe në vlerë të rritur për 475 mijë €. Ne kemi pyet dhe ju nuk jeni përgjigj, prandaj po pyes se cila është arsyeja që të rritet pesë fish mirëmbajtja e rrugëve?

-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve vitin e kaluar ka qenë 12 mijë e 550 €, kurse këtë vit është 124 mijë e 900 € e që i bie për 116 mijë € më shumë. Ne nuk e kuptojmë pse ky shpenzim është rrit 1000% apo dhjetë fish është rrit shpenzimi për të njëjtin shpenzim dhe për të njëjtën kompani.

-Te transporti i nxënësve për tri vite në të kaluarën kaënë 200 mijë 649, kurse tash është tenderi në vlerë prej 412 mijë € dhe kjo i bie për 142 mijë € më tepër për shërbimin e njëjtë. Gjithashtu dihet se çmimi i naftës ka qenë në të kaluarën për 40% më i shtrenjtë dhe në vend se të ketë ulje për 40% ju keni bërë rritje.

-Te pastrimi i objekteve shkollore e dimë se po të njëjtat shkolla janë në Komunën e Gjilanit që kanë qenë edhe para tri vite edhe sot shuma është 257 mijë € për tri vite, kurse ju tash keni dhënë tender për mbi 415 mijë €.

Në total vetëm këto vërejtje për pa i analizuar të gjitha keni i shpenzuar 1 milion e 32 mijë e 500 € më shumë se të njëjtat projekte që i keni dhënë viteve paraprake.

Të gjitha këto që po i ngrit kisha kërkuar përgjigje një nga një?

Përveç këtyre problemeve kemi probleme me vonesa të cilat kjo Zyrë i bën në vlerësimin e ofertave të dosjeve të tenderëve që i dorëzojnë operatorët ekonomik dhe kjo vonesë bëhet deri në 60, 90, por ka rast dhe deri në 120 ditë vonesë dhe nuk vlerësohet nga komisioni i emëruar nga ju. Cila është arsyeja që një tender një muaj deri në katër muaj të mos vlerësohet? A qëndron ajo z. drejtor ajo që ju keni presion nga zyrtarët komunal dhe kryetari që të detyroheni që t'ia jepni tenderin ndonjë kompanie të preferuar nga ata?

Është interesant edhe një fakt që tenderët me kuotim mbi 10 mijë €, zgjat vetëm 3 ditë, vlerësimi se kujt t'ia epet tenderi. Ne i kemi të dhënat e sakta dhe tenderë me kuotim janë dhënë në vlerë deri në 10 mijë € dhe është një numër i konsiderueshëm dhe është interesant se të gjitha kanë vlera përafërsisht të njëjta si 9784 €, 9864 € etj.

Është edhe një fakt se shumë tender janë dhënë për kompanitë jashtë Gjilanit për këto dy vite dhe si është e mundshme që 9 tender që janë dhënë me kuotim edhe në vitin 2014 dhe 2015 janë dhënë përmes kuotimit. Si ka mundur një Kompani nga Suhareka, Prishtina dhe vende të tjera të vijë në Gjilan dhe ta dinë se qenka një tender me kuotim, sepse këta tender nuk shpallen? Kompanitë e Gjilanit nuk e dinë se ka tender me kuotim, prandaj më intereson se cila është mënyra e komunikimit për këto raste dhe kërkoj përgjigje?

Komuna e Gjilanit për këto dy vite i ka dhënë 36 tenderë për kompanitë jashtë Gjilanit në vlerë prej 2 milion e 133 mijë €. Kjo është një shumë e lartë dhe duke pasur parasysh se ky buxhet po të ishte shfrytëzuar në bizneset e Gjilanit ato sot do të ishin shumë më të fuqishme. Gjithashtu është dhënë një tender 9.744 € për kompaninë “Gishtat” nga Prishtina e cila ka të bëjë me organizmin dhe pritjen e punëtorëve nga diaspora. Ky manifestim është organizuar në muajin korrik dhe gusht të vitit 2015, kurse tenderi është dhënë në muajin shtator 2015. Janë organizuar të gjitha aktivitetet, kurse ju e keni shpall tenderin pasi është kryer ky organizim dhe kjo është një shkelje jashtëzakonisht e rënë për të cilën kërkoj përgjigje? Mandej keni tender për drunj dekorativ dhe fotokopjues dhe i keni marrë në Prishtinë thuaja se nuk paska në Gjilan.

Kemi bërë kërkesë për komisionin i cili është duke e bërë këtë vlerësim të ofertave dhe obligim ligjor e keni për të na dhënë përgjigje brenda 7 ditëve, por nuk na keni dhënë asnjë përgjigje? Cilat janë arsyet që ju nuk na i jepni emrat e komisioneve të cilët i vlerësojnë ofertat e të gjitha kompanive për të gjithë tenderët e Gjilanit? Po ashtu nuk e dimë edhe listën e komisionit për pranim teknik e që po ndikon në kualitetin e punëve që po kryhen.

Qasja në dokumente zyrtare po e theksoj z. drejtor është 7 ditë, prandaj për herë të fundit po të kërkoj që respektojë këtë afat ligjor.

Kërkova më parë, por nuk u përgjigje dhe janë tri grande të mëdha nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e projekteve kapitale në Komunën e Gjilanit. Sa janë shfrytëzuar ato grande dhe po të lus që të japësh përgjigje sot?

Unë në fund vlerësoj se kjo drejtori ka nevojë shumë për ta përmirësuar punën e vetë dhe së pari ta respektojë ligjin, procedurat ligjore të jetë transparente dhe mos të ketë frikë nga qasja në dokumente zyrtare.

Nevzad Isufi- ne e kemi dërguar një kërkesë përkitazi me shqyrtimin e Raportit të Departamentit të Prokurimit në veçanti për shkelje të procedurave ligjore në periudhën janar-nëntor. Drejtori e ka pasur këtë kërkesë dhe gjatë raportimit asnjë fjalë nuk dëgjova që është si përgjigje në këtë kërkesë. Gjithashtu mendoj se ato që i përmendi kolegu Riadi janë plotësisht të qëndrueshme dhe këto nuk janë vetëm vlerësime tonat, por vlerësime të tilla nga njerëzit më profesional dhe ne pikërisht në ato organe po thirrëmi si në OSH, në Agjensionin Kundër Korrupsionit e të cilat i kanë konstatuar këto shkelje.

Nuk është mundur që të ketë shkelje me dhjetëra e dhjetëra tenderë e të cilët nuk janë bërë pa qëllim, ose është deshtë të shpjegohet pse janë bërë?

Gjithashtu nuk u përmend numri i madh tenderëve të anuluar dhe të cilat kanë qenë vërejtje serioze nga raporti i KDI-së, dhe nuk bëhet fjalë për vërejtje çfarëdo, por për vërejtje serioze. Nuk u përmendën operatorët të cilët janë vonuar në realizmin e projekteve të tyre, çka ka ndodhur me ta dhe cilat janë mënyrat që është iu vazhduar kontrata përkundër asaj që nuk i kanë përmbushur obligimet me kohë?

Unë mendoj se nuk kemi nevojë të fshehim asgjë dhe nëse ndodh që dhe Komuna sa i përket transparencës, qoftë edhe për plane të prokurimit duhet t' i paraqes në Kuvend dhe në raport nuk duhet të jetë asgjë e fshehur, sepse ato gjëra më kanë kaluar.

Isa Agushi- unë po inkuadrohem, sepse atë çka e thanë parafolësit e mi, nuk e di pse drejtori është këtu, sepse sipas tyre ai duhet të jetë në burg! Kaq shkelje të mëdha paska dhe kaq keqpërdorime të mëdha paska dhe sot nuk ka qenë deshtë të vijë drejtori të jap raport, por zëvendësi i tij, kurse drejtori duhet të jetë në burg, sipas meje.

Unë nuk po mbroj drejtorin në këtë rast, por sipas parafolësve për mua kjo është çështje shumë brengosëse për mua personalisht dhe nuk po flas në emër të grupit. Nëse ka kaq shumë shkelje dhe këso parregullsi, atëherë prokurori është në Gjilan dhe duhet ta fusin në burg kush ka vjedh. Unë po çuditem me parafolësit të cilët patën akuza të rënda, por pse nuk i dërgojnë në organet përkatëse dhe le të shkojnë në burg keqpërdoruesit. Nëse opozita ka prova, unë pajtohem plotësisht me ata, por nëse nuk kanë, atëherë mos flisni kot.

Avdyll Aliu- z. Isën e nxitën të tjerët, kurse mua më nxiti Isa për të reaguar. Po e informoj Isën, sepse është i painformuar. Shumë çështje që këtu u thanë edhe shumë të tjera që janë thënë këtu i kanë dërguar në Prokurori. Është marrë prokuroria me ato dhe për shumë raste ka kthyer përgjigje dhe ato kanë qenë pozitive. Kjo ishte sa për informim.

Arben Mehmeti- unë jam pjesë edhe e së kaluarës dhe jam jashtëzakonisht njohës i mirë për të kaluarën, sikurse që është edhe Riadi. Mirëpo di që edhe problemet më të mëdha paraqiten në Prokurim. Unë e di se çfarë keq menaxhimi ka qenë në të kaluarën prej kësaj Zyre të Prokurimit dhe aty është i njëjti staf me përjashtim të drejtorit. E tërë procedua bëhet nga stafi i drejtorisë aktuale dhe që janë staf kryesisht i rekrutuar në kohën e ish kryetarit të Komunës. Është mirë që tash tenderët e kanë shkallën e ankesave e që e dimë të gjithë, prandaj nuk është morale për të bërë akuza të pabaza, sepse janë organet profesionale që merren me rishqyrtimin e tenderëve si është OSHP-ja dhe komisionet e tjera që merren dhe institucionet e ndryshme që merren me monitorim. Kemi një vlerësim pozitiv të një organizate me renome në këtë fushë dhe po ashtu nuk kemi në raport vlerësime negative përkitazi me tenderët e Komunës së

Gjilanit. Numri i ankesave është në minimum dhe po ashtu edhe numri i rishqyrtimeve. Te çështja e tenderëve me kuotime, ju po e shihni se në çfarë gjendje tash gjendet Kosova, por edhe komunat përgjithësi, prandaj edhe në nivelin qendror ka interesa të ndryshme, por edhe në organe që merren me ankesa në OSH dhe organe të tjera ka të cilët janë duke u hetuar. Në Komunë të Gjilanit shumë tenderë kanë dështuar për shkak të procedurave, sepse janë procedurat e tej zgjatura dhe është normale që Komuna e Gjilanit t' i zbatojë tenderët deri në 10 mijë €, sepse përndryshe mund të jetë pengesë e madhe për funksionimin e shumë shërbimeve në Komunë të Gjilanit.

Nevzad Rushiti- në bazë të raportit, në bazë të asaj që u tha dhe në bazë të materialit që e kemi shihet se kjo drejtori i ka bërë 124 aktivitete e që janë jashtëzakonisht shumë për vitin 2015. Këto aktivitete vërehen në terren dhe në fshatra dhe në qytet, por normalisht se ka pasur edhe probleme teknike dhe probleme të tjera. Unë mendoj se çdo projekt që është realizuar në Komunë të Gjilanit i ka edhe paramasat e veta, prandaj nuk besoj se do të dalin aso shkelje që i thanë disa kolegë dhe kemi bindjen se edhe më 2016 do të kemi shumë projekte dhe do t' i realizojmë. Të gjithë ato që u thanë sot, unë personalisht i besoj dokumenteve që i shpalosi drejtori dhe fjalën që e tha. I uroj punë të suksesshme drejtorit duke dëshiruar që viti 2016 të jetë sukses i madh dhe do të jemi të kënaqur me investimet që do të bëhen.

Riad Rashiti- unë po i ripërsëris disa gjëra që i thash më herët. Unë u bazova në të gjitha faktet dhe dokumentet zyrtare, qoftë nga Agjensioni Kundër Korrupsionit, qoftë KDI-së, qoftë OSHP-së dhe asgjë nuk kam shpikur nga vetja dhe unë gjithçka jam bazuar në fakte dhe nuk ia kemi fut kot në këto të dhëna statistikore. Sa i përket Prokurorisë është e vërtetë se është duke u punuar, por pritni edhe pak dhe i dëgjoni zërin.

Te Zyra Prokurimit u tha se është i njëjti staf i cili e ka kryer punën edhe në qeverisjen e kaluar, kjo është e vërtetë, por mënyra e udhëheqjes së kësaj zyre dhe mënyra e shpenzimit të buxheti komunal është absolutisht ndryshe. Unë po i lexoj dy rreshta të raportit që i ka sjell drejtori: “për mirëmbajtjen teknike të objekteve komunale e që është dhënë tenderi ka qenë vlera e parashikuar e kontratës 180 mijë €. Çmimi i kontratës duke i përfshirë të gjitha taksat është dhënë 1 milion e 100 mijë e 335 €. Nëse është gabim teknik ta thotë drejtori, por ka qenë e planifikuar 180 mijë dhe është kontraktuar mbi 1 milion e 100 mijë €, unë nuk e di kujt po i besoni?

Cila është arsyeja që të rritet vlera e kontratës nga ajo që është planifikuar?

Mirëmbajtja e nxehjes qendrore në institucionet e Komunës së Gjilanit vlera e parashikuar 50 mijë €, kurse e kontraktuar mbi 112 mijë €. Furnizim me inventar për nevoja të Komunës (rreshti 24), vlera e parashikuar 25 mijë €, kurse tenderi është dhënë mbi 96 mijë €. Furnizim me tonerë 25 mijë me 51 mijë etj.

Po të ishte 100% rritja do të ishte mirë, por ka ndodhur 8-10 herë janë rritur tenderët.

Ne nuk po shpifim dhe nuk po paraqesim shënime jo të sakta, por po japim të dhëna nga dokumentet zyrtare.

Shukrie Rapuca- sot shumë u debatua për profesionalizëm dhe jo profesionalizëm, por po iu lus se çfarë profesionalizmi duhet për ta kuptuar një fakt? Jabanxhitë kur i fitojnë 36 tenderë dhe me këtë fjalë popullore kryetari Lutfi Haziri, asnjëherë nuk i ka huq vetëm duke thënë: “ky pushtet jabanxhinjt i kënaqi”. (është fjala për qeverisjen e kaluar) dhe po i diskriminon biznesmenët vendor. Tash a kërkon komet se këta jabanxhi kush po i kënaq?

E dyta një parafolës e tha: “se sa mirë i di unë mirë punët e pushtetit të kaluar”? Mirëpo, populli thotë: “sa lehtë e sheh qimen në shtëpi të huaj, kurse në shtëpinë tënde nuk e sheh as tranin”. Kështu ndodh me këta parafolësit e tenderëve këtu.

Sali Kçiku- së pari kërkoj falje që nuk kam pasur mundësi t' i kthej përgjigje Riadit për qasje në dokumentacion, por aq shumë ka pasur kërkesa sa që për të dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet duhet

formuar një dosje shuamë të madhe, prandaj të lus që nga dita e nesërme mund të vish në Departament të Prokurimit dhe për çdo gjë të intereson mund të kesh qasje.

Sa i përket ftesave për kuotim, unë po e jap një krahasim dhe aktivitete të prokurimit në vitin 2013 kanë qenë 140, ndërsa në vitin 2015 kanë qenë 124 aktivitete. Procedurë të hapur më 2013 kanë qenë vetëm 34, kurse më 2015 janë 77. Ftesë për kuotim në vitin 2013 kanë qenë 80, kurse më 2015 janë 29.

Vlera minimale në aktivitete ka qenë 26, ndërsa aktivitete më 2015 janë vetëm 13. Kur ta marrim dhe e bëjmë një analizë dhe kur i marrim parasysh 80 tenderë të papublikuar dhe 26 tenderë me vlerë minimale e arrin vlerën 1 milion €, e të cilat nuk janë publikuar fare dhe 80 janë po në atë vlerë si tha Riadi 9985. 9890 etj., kurse me vlerë minimale janë 29 dhe kështu vlera e këtyre tenderëve është afër 1 milion €, nuk janë publikuar fare.

Sa i përket planifikimit të prokurimit, është mirë për ta lexuar Ligjin e prokurimit dhe ato ndryshimet që janë bërë me 21 janar dhe atëherë mund të bisedojmë, sepse nuk ke informata dhe nuk e njeh ligjin dhe për këtë arsyeje flet kot. Plani i prokurimit është Ligji-04-L042, neni 21 thotë :”planifikimi duhet të jetë transparent vetëm te OSHP-ja”, ashtu siç e shpjegova më herët se për cilat organe duhet të jetë.

Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit është se ky aktivitet nuk ka qenë i paraparë me planifikim të vitit 2015, sepse Drejtoria e Shëndetësisë nuk e ka paraparë dhe është anuluar. Subvencioni te normat për këtë vijë të bizneseve, ky aktivitet nuk ka qenë i paraparë dhe njësia kërkuese e ka dorëzuar për procedim. Furnizim dhe montim i aparaturës digjitale për votimin dhe leximin elektronik për sallën e Kuvendit Agjensioni Kundër Korrupsionit e ka rekomanduar për anulim të procedurës së prokurimit, sepse kanë ndodhur disa lëshime teknike nga njësia kërkuese për shkak të specifikacionit.

Sa i përket mirëmbajtjes verore të rrugëve është e vërtetë se është rritur vlera, por duhet pasur parasysh se është rritur vlera në metër dhe jo në çmim, do të thotë sasia është rrit, sepse i kemi në plan rrugët edhe në qytet dhe në fshatra dhe është e paraparë edhe rruga për Pogragjë në kuadër të këtij projekti. Mirëmbajtja e rrugëve dimërore, vitin e kaluar e kemi shpallur tenderin dhe kemi pasur ankesë dhe lënda ka shkuar në OSHP dhe për shkak të rrezikut që mund të paraqitet për qytetarë na është dashtë të bëjmë ftesë për kuotim dhe i kemi bërë dy ftesa të tilla në vlerë prej 18 mijë € dhe kur është kthyer përgjigja si pozitive, atëherë e kemi lidhur kontratën me operatorin edhe 12 mijë e 500 € dhe kjo vlerë është 30 mijë € dhe janë vlera të përafërta. Sa i përket komisionit të vlerësimeve është e vërtetë se i kemi disa vonesa, por siç e dini edhe ju këto komisione janë paguar.

Furnizimi me tonerë ka qenë një tender i përbashkët për katër komuna, Gjilan, Viti, Kamenicë dhe Ranilluk dhe është anuluar dy herë dhe kemi qenë të obliguar ta shpallim të tretën herë dhe qëndron ajo se e ka fituar një operator nga Komuna e Prishtinës.

Sa i përket kompanive përfituese 80% e projekteve janë marrë nga kompanitë e Gjilanit. Te mbikëqyrjet ka pasur disa probleme, sepse këto më herët janë bërë me pagesë, kurse tash bëhen nga zyrtarët komunal e të cilët i falënderoj, sepse edhe pas orës 16 dhe pas orarit të punës dhe ditëve të shtune pa kompensime e kanë kryer punën ashtu si duhet, por më vonë e kemi bërë edhe një ftesë për kuotim dhe kemi zgjedh një operator për mbikëqyrje. Do t’i përgjigjem edhe anëtarit të tjetër të Kuvendit, sepse edhe kryetari ka pohuar se do të shpërblehet çdokush që i njofton organet përkatëse për ndonjë shkelje ose korrupsion . Unë besoj se e kam kryer punën me nderë edhe pse Departamenti i Prokurimit është një ndër drejtoritë që ka më së tepërmi procedura të komplikuara.

Riad Rashiti- z. Kçiku nuk ma dha një përgjigje se cila është arsyeja për anulim të nderti për furnizim me barna e të cilin tenderë e ka anuluar Agjensia Kundër Korrupsionit. Nuk u përgjigj te KDI-ja pse ka dhënë vlerësime negative. Asfaltimin e rrugës për Pogragjë nëse e keni paraparë si mirëmbajtje, kjo është absurde! Asfalti i ri dhe rrugët e reja nuk përfshihen në mirëmbajtje dhe kjo është mashtrim nga premtimet që janë bërë për asfaltim të asaj rruge. Nuk u përgjigje te lista në bazë të tabelës dhe cila është arsyeja parashikimi 180 mijë €, kurse tenderi për mirëmbajtje teknike keni kontratë 1 milion e 138 mijë dhe vetëm në këtë pyetje përgjigju? E thatë se komisioni i vlerësimit të ofertave është paguar, por absolutisht kurrë nuk është paguar? E thatë se nuk janë dhënë tenderë jashtë Gjilanit, por unë po mundohem shumë shpejtë dhe këto janë : “Pro –Arting” Ferizaj, 25 mijë, “Edona” Prishtinë -18 mijë €,

“Siti Computer”-Prishtinë, “Edona –Lonard Trans” Ferizaj 111 mijë dhe në vijim të fjalës së tij z. Rashiti i theksoi edhe shumë kompani të tjera që kanë fituar tenderë dhe jashtë Komunës së Gjilanit. Drejtori nuk duhet mohuar asgjë që është e vërtetë, sepse janë dokumentet që i vërtetojnë këto gjëra.

Sali Kçiku- unë e mora mesataren dhe e thash se 80% e buxhetit janë kompani të Gjilanit, kurse 20% jashtë Gjilanit. Mirëpo janë edhe disa kompani si ajo për rrënim të objekteve që është nga Kaçaniku dhe nuk ka konkurruar askush. Është ajo për ushqim të kafshëve “Ylli”, por nuk ka konkurruar askush, po ashtu edhe furnizim me barna nuk ka pasur asnjë kompani që ka konkurruar nga Gjilani, po ashtu edhe “Haxhi Jaha”, nuk ka pasur më kompani nga Gjilani dhe nuk kemi pasur rrugëdalje tjetër. Ju e dini ligjin e prokurimit i cili nuk ia mohon askujt të drejtën e konkurrimit, por as të drejtën për të fituar projektin nëse i plotëson kushtet. Unë kam kërkuar edhe jashtë ligjit për ta pasur edhe një njësi dhe rast konkretë është tenderi për furnizim me të çerdheve me ushqim dhe si kriter e kam paraparë që të ketë edhe një njësi.

Mirëpo KRPP ka bërë ankesë dhe ka preferuar se duhet ta heqim, por si mund të arsyetohet tash që për dy lakra duhet të vijë prej Prizrenit për t’i sjell në çerdhe ose një kg. molla ose byrekë për çerdhe, përsëri duhet të vijë dy orë prej Prizrenit. KKRPP e ka anuluar dhe ka thënë jo atë kriter.

Të ndryshme

Rexhep Kadriu- po i përgjigjem anëtarit të Kuvendit z. Sylejmani për Dardaninë i cili projekt ka përfunduar para një muaji, por ne në konsultë me KE-në, sepse KE është financues, kurse zbatues “Jomi” dhe zyrtarët e KE e kanë caktuar një datë 14 janarin për t’u bërë inaugurimi, por është shtyrë kjo datë, por më 10 shkurt është caktuar data e inaugurimit të projektit, prandaj shfrytëzoj rastin që të vini atë ditë dhe të jeni prezent, sepse është një ndër projektet më të mira të kësaj qeverisje. Ne nuk do të ndalemi me kaq, sepse ndërtimi i çerdhes dhe terrene tjera sportive do të fillojë po në atë lokacion.

Ramiz Ramadani- unë së pari e kam një vërejtje dhe pajtohem me z. Sylejmanin, sepse pyetjet po bëhen në fillim, kurse përgjigjet të epen në fund të seancës po e humb kuptim kjo mënyrë e punës së seancës. Ne nuk po përtojmë për të pritur, po mendoj se duhet zgjidhur këtë problem ndryshe dhe ose duhet të përgjigjemi aty për aty, por nëse nuk mundemi të japim përgjigje dhe nuk jemi të përgatitur, çfarë të keqe ka të përgjigjemi në seancën e radhës ose me shkrim? Nëse nuk mundet në këtë mënyrë, atëherë jam shumë kategorik që pyetjet të na bëhen në këtë kohë (nën të ndryshme) dhe të përgjigjemi menjëherë.

Sa i përket pyetjes së z. Abazi e ndiej për obligim për ta shpjeguar se në cilat baza ligjore rregullohet kjo fushë (zhdukja e qenve e endacak) dhe po e them se është Ligji i veterinarisë i vitit 2004/21 dhe është ligji për përkujdesjen ndaj kafshëve 02L-10 dhe Udhëzimi administrative 2005. Konformë këtij ligji edhe më 2014 dhe 2015 e kam trajtuar këtë fushë. Kjo fushë nënkupton vaksinimin klinik të qenve që nënkupton, vaksinim, sterilizim, kastrim, matrikulim dhe kthim në habitat. Kjo është formë moderne, kjo është mënyrë evropiane dhe bota kështu funksionon. Kjo te ne nuk po trajtohet në nivel vendi, por po e trajtojmë parciaisht komunë për komunë. Jemi ndër komunat e pakta që e trajtojmë këtë dukuri në Kosovë, por efekti bie, sepse Kamenica kurrë nuk është marrë me këtë punë, por as Vitia dhe Novo Bërda. Unë mendoj se kjo çështje duhet trajtuar në nivel vendi. Fusha e dytë që më lejon ligji është ajo me eutonazi dhe kjo bëhet me vlerësim të veterinarit dhe ai duhet ta përcaktojë se ndonjë qen a është i rrezikshëm apo jo? Nëse është i tillë me eutonazi e eliminon. Jashtë kësaj forme ligjore nuk ka vullnet për të vepruar ?

Shukrie Rapuca- z. drejtori ka diskutuar sikur të ishte në atë sallën e madhe të Strasburgut dhe shumë interesant diskutim me këtë profesionalizëm dhe me këto metoda, por harroi se ku është dhe në cilin

vend dhe çfarë problemi është ky? Më thua z. drejtor se çka do t' i thuash një nëne ose një babai i cili mund të mbetet pa fëmijën e tij (sajë)? Të na thotë drejtori se çfarë metoda do t' i shpjegojmë nxënësve tanë, kur vetëm në Shkollën “Abaz Ajeti” grumbullohen 30 e më tepër qen. Unë vetë me sytë e mi i kam, parë, por ishte një fat që nuk ishte asnjë nxënës në shkollë. Që nga ajo ditë (të keni kujdes), më nuk i ngjan shkolla shkollës, por oborri mbushet si të ishte si një tubim popullor, sepse të gjithë prindërit vijnë në mëngjes me fëmijët e tyre. A kanë kohë prindërit tanë ta dërgojnë dhe ta marrin fëmijën nga shkolla? Kjo nuk ka koment!

Ramiz Ramadani – zonja Shukrie unë di të flas edhe si në Zabel, unë po iu a jap vlerësimin maksimal, por ju më jepni alternativa. Dhe më thoni se këto rregullativa nuk janë të mundshme në vendin tonë, por e ke këtë dhe këtë mundësi? Nëse kërkon për ta shkel ligjin, unë po them se nuk jam i gatshëm dhe nuk jam i vullnetshëm për ta shkel ligjin. Ju si Kuvend merreni një vendim dhe t' i angazhojmë tri shoqatat dhe le t' i vrasin, pastaj unë jam i detyruar për të vepruar sipas vendimit të Kuvendit.

Fehmi Sylejmani- unë i pata dy pyetje për drejtorin e Shëndetësisë, por është kryetari i Komitet, por e kam edhe një pyetje. Një pikë e postës është vendosur te ish objekti Bankosit në katin e dytë, kur është vendos me çfarë dispozita ligjore dhe çfarë përfitimi ka Komuna nga kjo pikë që është vendos duke e ditur se PTK është një kompani profitabile? Edhe një vërejtje tjetër, sepse pasi nuk po funksionon Drejtoria e Inspeksionit Ligji për duhanin fare nuk po përfilllet, prandaj kërkoj që ta zbatojmë këtë ligj në vend.

Nevzad Isufi- unë kam një pyetje për drejtorin e Shëndetësisë e cila u përmend edhe më herët dhe në gazetën ditore të 23 dhjetorit të vitit 2015 thuhet se: “fondi humanitar i Drejtorisë së Shëndetësisë i bëri me shtëpi 24 familje, por edhe meremetimi i 40 shtëpive të tjera dhe është bërë pagesa e qirasë mujore për 35 familje? Pyetja është kush dhe kur e ka themeluar këtë fond humanitar dhe a ka ndonjë rregullore për themelimin e këtij fondi dhe a ka ndonjë bord apo komision për menaxhim të këtij fondi dhe cilat janë kriteret për ndërtim të shtëpive nga ky fond, por edhe për meremetim dhe pagesë të qirasë?

Pyetja tjetër është shpallur tender për meremetimin e dy shtëpive dhe këto ndërtime për të cilat po pyesim a janë të përcjella nga zyrtarët profesional të Komunës? A bëhet pranimi teknik i këtyre shtëpive dhe a regjistrohen në Drejtorinë e Kadastrit në pronësi të përfituesve. Një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, sepse vetëm një pjesë e qytetit ka gypa për grumbullim të ujërave atmosferike, por ka raste kur kemi lidhje në këtë rrejt nga qytetarët (që ka qasje të kanalizimit në rrejt të ujërave atmosferike). A jeni në njohuri për këto raste dhe pse p ndodh kjo në qytetin tonë?

Jashar Jashari- unë po i përgjigjem z. Sylejmanai, kurse për pjesën tjetër do të epet përgjigja nga drejtori i Shëndetësisë. Sa i përket barnatore që punon në QKMF dhe është e vërtetë se kjo barnatore nuk punon që nga viti 2012 me dy ndërrime, por unë në fillim të janarit unë kam kontaktuar me drejtorin dhe kolegë dhe të gjithë e kanë mirëprit një ide të tillë që kjo barnatore të punojë deri në ora 20. Sa i përket QMF-së në Zhegër, tash pasi është bërë pranimi i shumë punëtorëve me siguri edhe aty do të fillojë edhe ndërrimi i dytë.

Naser Korça- pyetje e parë për Shërbimet Publike ishte nga zonja Rapuca e cila pyetje ishte për ndriçimin publik në Zabel. Unë me sa e di aty ka ndriçim, por edhe ka ankesa se ka ndriçim të tepërt dhe po i pengojnë qytetarët. Sa i përket shiritave në rrugë (vijave të bardha) ende nuk e kemi ndonjë kontratë të qëndrueshme për sinjalizim horizontal dhe vertikal dhe këto vija të bardha hyjnë në kuadër të asaj kontrate dhe procedurat e prokurimit janë bërë dy herë, por janë anuluar për shkak të ankesave e që nuk është faji i jonë, por i OSHP-së ose KRPP-së. Në momentin që të kemi kontratë vijat e bardha do të rregullohen.

Trotuari në rrugët e Prishtinës, por aty është bërë ndërrimi i gypit të ujës-jellës në pjesën e djathtë, por do të bëhet edhe në anën e majtë dhe në çastin që do të përfundojnë ato riinstalime të gypit do të intervenohet në tërë aksin e rrugës së Prishtinës, si në trotuare dhe në pjesë të tjera të kanalizimit. Pika e PTK-së është hapur me të vetmin qëllim të mirë për qytetarë të cilët nuk kanë nevojë të dalin jashtë objektit për ta bërë ndonjë pagesë, por këtë shërbim mund ta kryejnë brenda. Kjo pikë iu është dhënë PTK-së pa asnjë kompensim. Infrastruktura për ujërat atmosferik mund të ketë raste të lidhjes së gypave të kanalizimit në gypat e ujëmbledhësve atmosferik, por në momentin që zbulohen, ne do të marrim masa. Çdo kush që ka informata të tilla le të lajmërojnë, ne do të marrim masa.

Me këto debate dhe vendime seanca parë i përfundoi punimet në ora 17.20 minuta.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi